

albISLAM

Faqe 4

Editoriali

Mos i mbyllni sytë...

Faqe 5-12

Aktuale

Të terrorizuar nga "Lufta kundër terrorizmit"

Myslimanët e Francës më të integruar në shoqëri

Pse Irani synon depërtimin në Egjipt

Faqe 12-25

Artikuj

Fi sebililah - Duhet të jetojmë...

Çka të pëlqen te muzika?!

Buzëqesh ...

Kriteret e të mençurve

Faqe 26-42

Tema

Konflikti ideologjik mes të vërtetës dhe të kotës (1/3)

Dispozita të nevojshme rreth leximit të Kuranit

Mos i shndërroni shtëpitë në varreza!

Faqe 43-59

Gruaja dhe familja

Dilemat e studenteve mes martesës dhe përfundimit të studimeve

A duhet të legalizohet aborti?

Si ta fitojmë dashurinë e bashkëshortes

Problemi i dezinformatave në shkolla mbi Islamin

Faqe 60-62

Pyetje përgjigje

Rroga e merituar

Faqe 63-65

Ilmihalli

Përshkrimi i momenteve të Ahiretit 2/2

Faqe 66

Letra

Letër maturantit

Mos i mbyllni sytë...

Sa e bukur është dita në pranverë. E kthjelltë, e ngrohtë, delikate, të fton që me gjitha shqisat ta jetosh atë. Të duket sikur asgjë nuk mund ta turbullon kthjelltësinë e ditës pranverore.

Por, ja që ndodhitë jo çdoherë u përshtaten dëshirave tona. Si të burgosurit, detyrohemi të ballafaqohemi me realitetin e dhimbshëm, gjendjen e vështirë të muslimanëve tek ne dhe botë.

Braktisja e shumë obligimeve fetare, akuzat e vazhdueshme në llogari të Islamit, etiketat e ndryshme fyese për besimtarët e përkushtuar, çoroditjet seksuale, abortet nëpër shkollat fillore, fëmijët e braktisur, dhuna ndaj tyre, ngacmimet seksuale janë vetëm disa nga lista e gjatë e problemeve që i brengosin muslimanët.

Fenomeni i "festave të stinës" nga ana tjetër tek shumica e njerëzve krijon një opsion të manifestuar në pyetjet nevrrike, si t'ia bëjmë, ku ti kalojmë, si të vishemi, si do t'ia bëjmë me dhuratat e kështu me radhë.

Festimi i maturës, dita e hyrjes në radhët e të pjekurve, ashtu siç është kuptuar nga shoqëritë tona, është dukuri problematike që është ngritur në shkallën e opsionit.

A jemi të pjekur, sepse sonte nën mbikëqyrjen e profesorëve tanë, gjërat që ishin të ndaluara për neve bëhen të lejuara? Në shoqëritë e "hapura" dhe "demokratike", si këto në të cilat jetojmë, alkooli, droga, orgjütë e shfrenuara në këtë natë fshihen nga lista e tabuve. Si duket tani jemi gati, t'i provojmë edhe këto dukuri "joshëse" të modernizmit. Ata që kanë dyshime kanë të drejtë të vërtetohen në këto pohimet tona.

Shpenzimi i shumë astronomike për këtë mbrëmje me siguri nuk flasin shumë për pjekuri. Ajo që të le pa fjalë, është fakti që shumë njerëz huazojnë të holla që fëmijëve të tyre t'ua mundësojnë pjesëmarrjen në shfaqjen e kësaj mbrëmjeje, në sfilatën e "pjekurisë". Si duket për fustanet "zhveshës" dhe kostumet "firmë" ka buxhet. Fatkeqësisht një zell i tillë, nuk tregohet kur janë në pyetje nevojtarët e popullit.

Është thënë: Fillimi i zgjidhjes së problemit është diagnostikimi i tij. Mendojmë se të mençurit e popullit këtë e kanë kuptuar. Atë që duhet ta bëjnë është t'i përveshin mëngët dhe t'ia fillojnë punës.

Tani mos i mbyllni sytë dhe vazhdoni të kënaqeni me bukuritë e pranverës. Besimtari më shumë se dikush tjetër e ka këtë të drejtë.

Zoti ju dhashtë të mira në dynja dhe në ahiret.

**Në emër të redaksisë:
Talha Kurtishi**

Të terrorizuar nga "Lufta kundër terrorizmit"

Zhignjev BZHEZHINSKI

Lufta kundër terrorizmit krijon kulturë të frikës në Amerikë. Ngritja e administratës së Bushit për këto tri fjalë në nivel të Mantrës (formulë magjike në bazë të besimit në fuqi të mbinatyrshme, sipas bramanëve dhe hindusëve) kombëtare pas 11 shtatorit ka ndikim të keq mbi demokracinë amerikane, mbi psiken amerikane dhe pozitën e ShBA-së në botë.

Përdorimi i kësaj fraze e varros përgatitjen tonë për një kundërshtim efikas me sfida reale me të cilat ballafaqohemi nga fanatikët të cilët mund të na kundërshtojnë me terrorizëm.

Dëmin që e bënë këto fjalë - një vetëplagosje klasike - gjithsesi është më i madh dhe i tejkalon edhe ëndërrat më të guximshme të shkaktarëve fanatikë të sulmeve të shtatorit të vitit 2001. Frazja vetvetiu është e pakuptimtë. Ajo nuk definon as kontekstin gjeografik, as armikun potencial.

Terrorizmi nuk është armik por teknikë e luftës - frikësim politik me vrasje të joluftëtarëve pa armë.

Përsëritja e shpeshtë e "luftës kundër ter-

Përsëritja e shpeshtë e "luftës kundër terrorizmit" bëri plotësimin e një caku të madh: Stimuloi shfaqjen e kulturës së frikës.



rorizmit" bëri plotësimin e një caku të madh: Stimuloi shfaqjen e kulturës së frikës.

Ajo i bën të paqarta shkaqet,

stimulon emocione dhe ua lehtëson demagogëve politik mobilizimin e publikut dhe qëllimeve të tyre politike.

Lufta në Irak nuk do ta fitonte përkrahjen nga Kongresi pa lidhshmërinë psikologjike mes tronditjes së 9/11 dhe postulatit për ekzistimin e armës irakiane për shkatërrim

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

në masë. Përkrahja për Bushin në zgjedhjet e vitit 2004, po ashtu, ishte e mobilizuar nga ajo se "kombi në luftë" nuk e ndërron komandimin gjatë kohës së luftës.

Duke theksuar se kjo luftë është thujse e njëjtë sikur ato kundër Nazizmit dhe Stalinizmit (duke injoruar faktin se Gjermania naziste dhe Rusia Sovjetike ishin forca të mëdha, ndërsa statusi i Al Kaedës madje as nuk mund të afrohet në atë nivel), administrata mund të përgatitë mundësinë për luftë me Iranin. Ky lloj i luftës atëherë do ta shtyjë Amerikën në konflikt të vazhduar ku do të ishin përfshirë Iraku, Irani, Afganistani, e ndoshta edhe Pakistani.

Kultura e frikës është si një xhind i liruar nga llamba. Ajo mund ta fitojë jetën e vet dhe mund të jetë demobilizuese. Amerika tani është e ndarë, e pasigurt dhe potencialisht nën ndikim shumë të madh të panikut në rast të sulmeve të reja terroriste mbi SHBA-të. Kjo është rezultat i larjes së trurit gjatë këtyre pesë viteve për terrorin, gjë që nuk ndodhi në disa vende tjera (Britani, Spanjë, Itali, Gjermani, Japoni).

Ky lloj i frikës që përhapet gjeneron një momentum (impuls) të veçantë. Terror-ndërmarrësit, zakonisht të përshkruar si ekspert për thyerjen e terrorizmit janë të kyçur në garën për vërtetimin e ekzistencës së tyre. Për këtë shkak, detyra e tyre është që ta bindin publikun se jemi duke u ballafaquar me kërcënime të reja.

Amerika po bëhet e pasigurt dhe gjithnjë e më tepër paranoike. Në vitin 2003 Kongresi shënoi 160 vende në SHBA si caqe potenciale të rëndësishme të terror-

Amerika tani është e ndarë, e pasigurt dhe potencialisht nën ndikim shumë të madh të panikut në rast të sulmeve të reja terroriste mbi SHBA-të. Kjo është rezultat i larjes së trurit gjatë këtyre pesë viteve për terrorin, gjë që nuk ndodhi në disa vende tjera

istëve. Deri në fund të po atij viti numri u ngjiti në 1.849, deri në fund të vitit 2004 në 28.360, që në vitin 2005 të arrijë në 77.769. Sipas të dhënave të tanishme në SHBA ka 300.000 caqe potenciale ndër të cilat janë Siars Tauer (Siars Tower) në Çikago dhe festivali i mollës dhe derrave në shtetin Illinois.

Javën e kaluar këtu në Uashington, gjatë vizitës sime në një zyre të gazetarëve, nevojitej të kaloj nëpër njërën prej atyre kontrolleve absurde. Një person në uniformë kërkoi nga unë që të plotësoj një formular, të tregoj letërnjoftimin dhe ta shpjegoj arsyen e vizitës sime. A do të ndodhte që një terrorist i cili vjen për vizitë të shkruante se qëllimin e ka "ta hedhë ndërtesën në erë?". A do ta arrestonte personi i uni-

formuar këtë person që pranoi vet, këtë vetëvrasës potencial - me bombë? Që absurdi të jetë edhe më i madh, qendrat e mëdha tregtare, sallat e koncertit ose kinematë nuk kanë asnjë procedurë.

Ky lloj i procedurës së "sigurimit" u bë rutinë, mbi të cilën hidhen qindra milionë dollarë dhe ka ndikim mbi okupim mental.

Qeveria në çdo nivel stimulon paranojën. Si shembull mund t'i merrni bilbordat elektronikë në autostradë ku shkruan "Paraqitni aktivitete të dyshimta (voztës

Ndërkohë, "lufta kundër terrorizmit" e dëmtoi rëndë Amerikën në nivel ndërkombëtar. Për këtë kontribuoi edhe lufta në Irak dhe trajtimi i civilëve irakianë nga ushtria amerikane, si ai palestinezëve nga ana e Izraelit.

me turban në kokë?) Në këtë paranojë ndikim kanë edhe mas-mediat. Disa kanale kablllovice dhe medime të shtypura, mendojnë se horror-skenarët e tërheqin publikun ndërsa ekspertët e "terrorit" dhe "konsultantët" japin vizione autentike të apokalipsës me të cilat ushqehet publiku amerikan.

Po ashtu, edhe industria zbavitëse (entertainment) hyri në lojë. Për këtë shkak TV serialet dhe filmat në të cilat e keqja njihet përmes linjave arabe, ndonjëherë e potencuar me gjestikulime fetare e shfrytëzon shqetësimin e publikut dhe e stimulon islamofobinë.

Është shumë shqetësues dhe një keqësim i gjithanshëm në sferën e respektimit të të drejtave të njeriut. Kultura e frikës shkaktoi jotolerancë, dyshim ndaj të huajve dhe procedura të cilat e varrosin kuptimin elementar të gjyqësisë.

I pafajshëm deri sa nuk vërtetohet, u shndërrua në - nëse nuk ka bërë.

Ndërkohë, "lufta kundër terrorizmit" e dëmtoi rëndë Amerikën në nivel ndërkombëtar. Për këtë kontribuoi edhe lufta në Irak dhe trajtimi i civilëve irakianë nga ushtria amerikane, si ai palestinezëve nga ana e Izraelit. Vetëm një Amerikë e rregulluar dhe racionale mund ta avancojë sigurinë elementare ndërkombëtare e cila nuk do të lërë hapësirë për terrorizëm.

Ku është lideri amerikan të thotë - Mjafton kjo histori, ndaleni paranojën. Madje edhe nëse ndodhin sulme të reja terroriste, një mundësi e cila nuk mund të mohohet, duhet të tregojë pak kuptim.

Përktheu: M. Abdullahu



Husamudin MUSTAFA

Myslimanët e Francës gjejnë lehtësi në integrimin e tyre në shoqërinë franceze për dallim nga vendet tjera evropiane. Cila është liria të cilën e gëzojnë myslimanët në Francë në lidhje me integrimin dhe identitetin? Si i shikojnë fetë tjera? Si i zhvillojnë mysli-manët besimet dhe simbolet e tyre në Evropë? Të gjitha këto pyetje i ka parashtruar qendra amerikane për studime të specializuara në çështjet e feve

Aktuale

"BioCenter" dhe të njëjtave u është përgjigjur në një raport të publikuar kohëve të fundit.

Ky raport në fillim thotë: integrimi i myslimanëve të Francës, numri i të cilëve është ngritur në më shumë se pesë milion myslimanë, paraqet përjashtim në mbarë Evropën. Në Britani 81% e muslimanëve besojnë se është normal të ndodhin konflikte kur realizohen ritet fetare islame në një shoqëri perëndimore.

Ky raport tregon se gjendja në Francë dallon tërësisht. Shtatëdhjetë e dy për qind e myslimanëve në Francë nuk shohin asnjë konflikt mes Islamit dhe Perëndimit.

Dyzet e gjashtë për qind e tyre Islamit e vendosin në rend të parë para çdo gjëje, kurse 42 për qind i konsiderojnë vlerat franceze para çdo gjëje. Myslimanët e Francës janë më të hapurit ndaj feve tjera në krahasim me myslimanët e Anglisë, Gjermanisë, Holandës dhe vendeve tjera evropiane.

Sa i përket arsimit, ky raport tregon se lëvizja e arsimit në Francë dëshmon komplot i cili e pengon lëvizjen integruese të shoqërive myslimane në Francë në formë të qartë, sidomos me arritjen e emigrantëve të rinj, të cilët kërkojnë më shumë kohë për integrim në shoqëri.

Ministri i Punëve të Brendshme i Francës, Nikola Sarkozy, kandidati për zgjedhjet presidenciale, thotë: më shumë se gjysma e institucioneve islame në Francë, të cilat kapin shifrën prej

2000 institucione, zhvillojnë mësimet islame në atë mënyrë siç zhvillohen edhe në vendet islame dhe arabe. Në këto institucione zakonisht janë të pranishëm marokenët, algerianët dhe turqit.

Drejtori për çështjet e feve në Ministrinë e Brendshme, Bernard Xhodar, tregon se vitet e fundit ka dëshmuar revolucion fetarizmi kolektiv i myslimanëve në Francë.

Sa i përket prapavijës politike, ky raport tregon se dobësia e integritit të

Sa i përket prapavijës politike, ky raport tregon se dobësia e integritit të myslimanëve në shoqëritë evropiane zakonisht ka të bëjë me qëndrimin e qeverive ndaj tyre, apo për shkak të përvetësimit të luftës kundër terrorizmit, e cila zakonisht myslimanët i vendos në listën e objektivave.

myslimanëve në shoqëritë evropiane zakonisht ka të bëjë me qëndrimin e qeverive ndaj tyre, apo për shkak të përvetësimit të luftës kundër terrorizmit, e cila zakonisht myslimanët i vendos në listën e objektivave. Prej shoqërive më të dalluara në këtë drejtim është komuniteti islamik në Britani, i cili vuan nga diskriminimi për shkak të politikës së kryeministrit

Toni Bler, i cili mbështet Amerikën në luftën e tij kundër terrorizmit.

Në Francë, sipas raportit, ndryshon gjendja, sidomos nën hijen e politikës së kryetarit aktual të Francës, Zhak Shirak, e cila politikë është kundër politikës amerikane në Irak, duke ia shtuar kësaj edhe solidarizimin me myslimanët në përgjithësi dhe arabët në veçanti.

Raporti përfundon duke treguar se në kohën e fundit të rinjtë myslimanë francezë janë të dhënë pas xhamive dhe thirrjes islame, sidomos me përhapjen e globalizmit dhe rënies kulturore dhe shoqërore.

Algjerianët paraqesin shumicën e komunitetit mysliman në Francë dhe përafërsisht paraqesin 800 mijë banorë, pasojnë marokenët, me 600 mijë, më pas tunizianët me 500 mijë banorë, ndërsa vijojnë afrikanët nga jugu i Saharës dhe libanezët myslimanë.

Vlen të përmendet se numri i myslimanëve në Francë arrin deri në gjashtë milionë, domethënë paraqesin 10 për qind të banorëve. Janë me prejardhje nga 53 shtete dhe flasin 21 gjuhë të ndryshme krahas frëngjishtes. Algjerianët paraqesin shumicën e myslimanëve të Francës.

Sipas statistikave, në mesin e këtyre gjashtë milionë myslimanëve në Francë, rreth dy milionë janë të lindur në Francë, shumica e tyre sipas terminologjisë algjeriane quhen "lëvizës", domethënë bijtë e atyre që kanë bashkëpunuar me Francën gjatë okupimit francez të Algjerisë. Kurse tjerët janë emigrantë që kanë ardhur nga shtetet islame dhe shtete të ndryshme arabe.

Në përgjithësi, algjerianët paraqesin shumicën e komunitetit mysliman në Francë dhe përafërsisht paraqesin 800 mijë banorë, pasojnë marokenët, me 600 mijë, më pas tunizianët me 500 mijë banorë, ndërsa vijojnë afrikanët nga jugu i Saharës dhe libanezët myslimanë.

Francezët myslimanë nuk paraqesin njësi kombëtare e as gjuhësore dhe kjo e sqaron faktin e ekzistimit të 2000 shoqatave islame me rrënjë të ndryshme kulturore, medhhebore dhe origjinë gjeografike.

Kjo llojllojshmëri u shfaq në mënyrë të qartë gjatë themelimit të këshillit

francez për fenë islame, ku ministri i Punëve të Brendshme tentoi të përfaqëson në këtë këshill 1500 xhamia dhe gjashtë shoqata më të mëdha, të cilat janë:

- Unioni i organizatave Islame në Francë, i cili organizon për çdo vjet konferencën e njohur si Burxhi. Është themeluar në vitin 1982 dhe dallohet me strukturimin e tij të mirë organizativ, pasi që dominon me 300 shoqata, më e dalluara është "Rinia Islame" dhe krahu i tyre studentor në Universitet, e cila njihet me emrin "Studentët Myslimanë".

- Xhamia e Parisit. Historikisht llogaritet si institucioni më i vjetër që përfaqëson myslimanët në Francë. Është themeluar në vitin 1926 dhe që nga fillimi është i lidhur me komunitetin algjerian në Francë. Financimi bëhet nga Algjeria. Dekani i kësaj xhamie, Delil Ebu Bekër, përkujdeset edhe për shtatëdhjetë xhamia tjera.

- Federata nacionale e myslimanëve të Francës. Përbëhet nga emigrantët marokenë dhe financohet nga mbreti i Marokut. Administrojnë disa xhami në periferi të Parisit dhe në lindje të Francës.

- Xhemati i Daves dhe Tebligut. Ka filluar aktivitetin në mesin e emigrantëve në fillim të vitit 1968 dhe ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për të kontaktuar me brezin e parë të emigrantëve. Aktiviteti i tyre koncentrohet në Njësinë e njëmbëdhjetë të Parisit, sidomos në rajonin Balfil.

Sipas parashikimeve, numri i myslimanëve të Francës do të shtohet për tri herë deri në vitin 2020, kur pritet që numri i tyre të arrijë në 20 milionë.

- Komisioni koordinativ i myslimanëve turq në Francë. Pason Dijanetin e Turqisë dhe menaxhon me 150 xhamia. Në aspektin ideologjik pason Mili Gyryshin, grupacion sufist i Turqisë. (Sipas meje, ky klasifikim është i gabuar, sepse në bazë xhamitë e turqve në përfundim ndahen në: ato të Dijanetit dhe të Mili Gyryshit, andaj s'ka mundësi të kenë këso lidhjesh mes tyre. Sh.p.)

- Unioni Francez i shoqatave islame në Afrikë, Kamerun dhe ishujt Antil: Ky union paraqet një komunitet të rëndësishëm, mirëpo nuk është i organizuar mirë, në përjashtim të disa organizatave që e pasojnë dhe nuk dominojnë me xhami të rëndësishme.

Përpos këtyre gjashtë unioneve të mëdha ekzistojnë edhe pesë xhami që marrin pjesë në Këshillin francez të fesë Islame dhe gëzojnë një peshë të madhe. Ato janë:

- Xhamia "Nanla Xholi".
- Qendra Kulturore Islame në Ivri.
- Xhamia e madhe në Lion.
- Xhamia e madhe në jug të Francës, "Islah".
- Xhamia e madhe e San Donie Dola Renon.

Sipas parashikimeve, numri i myslimanëve të Francës do të shtohet për tri herë deri në vitin 2020, kur pritet që numri i tyre të arrijë në 20 milionë. Si shkak për këtë paraqiten nataliteti i madh në mesin e tyre, ardhja e vazhdueshme e emigrantëve myslimanë në Francë dhe konvertimi në Islam i një numri jo të vogël francezësh. Numri i francezëve myslimanë është mbi 100 mijë.

Përktheu:
Bekir HALIMI

Pse Irani synon depërtimin në Egjipt

Usame SHEHADE

Dallimi mes mënyrës së veprimit të dy krahëve iranië buron në prapavijën ideologjike të secilit krah. Përderisa Ahmedî Nexhad pason grupin "Huxhetie", i cili ka pasur rol negativ kundrejt ndihmës së revolucionit të Homeinit, sepse beson se trazirat dhe e keqja e shpejton "Ardhjen e Mehdiut", krahu tjetër, Rafsanxhani, Hatemi dhe Kurubiu besojnë në aktivitetin për ndërtimin e shtetit shiit si shpejtim të "kthimit të Mehdiut". Këta të fundit mendojnë se në disa raste duhet pranuar edhe armëpushimin me qëllim që të arrihen rezultate më të mëdha ose që të shmangen humbje të mëdha.

Ligjërata e ish-kryetarit iranian Hatemi në bibliotekën e Aleksandrisë, konsiderohet sukses i ri për krahun për manovrim të Iranit, Rafsanxhani, Hatemi dhe Kurubiu, përballë krahut të kryetarit radikal Ahmedi Nexhad.

Ky konflikt mes këtyre dy krahëve paraqet garë se cili do të realizojë interes më të madh për revolucionin iranian dhe Vilajetul-Fekihun. Andaj askush nuk duhet të mendojë se aty njëri krah është më i mirë se tjetri, sepse gara është në mjete e jo në parime.

Dallimi mes mënyrës së veprimit të dy krahëve buron nga prapavija ideologjike e secilit krah. Ahmedi Nexhad pason grupin "Huxhetie", i cili ka pasur rol negativ kundrejt ndihmës së revolucionit të Homeinit, sepse beson se trazirat dhe e keqja e shpejton "Ardhjen e Mehdiut", andaj konsideron se përkrahja e revolucionit të Homeinit e pakëson të keqen!!

Mirëpo me kalimin e një çerek shekulli nga themelimi i Republikës Iraniane, kryetari i saj Ahmedi Nexhad ka filluar të mendojë se pjesëmarrja në rritjen e konfliktit do ta përshpejtojë ardhjen e Mehdiut, meqë shpresa e kryetarit Nexhad, sipas memoareve personale të tij, është të jetë ushtar i Mehdiut.

Krahu tjetër, Rafsanxhani, Hatemi dhe Kurubiu, nga ana tjetër, besojnë në aktivitetin për ndërtimin e shtetit shiit si shpejtim i "kthimit të Mehdiut" dhe kanë përfituar nga përvoja e Homeinit në qeverisjen e Iranit. Ata mendojnë se në disa raste duhet pranuar edhe armëpushim me qëllim që të arrihen rezultate më të mëdha ose që të shmangen



humbje të mëdha, siç është shprehur Homeini "gëlltitjen e helmit", kur pranoi ta ndalë luftën me Irakun.

Nga ky aspekt politika e Hatemit u cilësua si "Hapje kulturore" përmes së cilës u arritën përfitime politike të mëdha për Iranin, mirëpo këto të arritura u avulluan për shkak të politikës konfliktuozë të Ahmedi Nexhadit.

Për të ruajtur të arriturat e mbetura dhe për ta mbrojtur revolucionin e Homeinit, domethënë Republikën Islamike, u formua boshti Rafsanxhani, Hatemi dhe Kurubiu.

Nga këtu buron edhe rëndësia e Egjiptit në agjendën e kësaj rryme. Mund ta kuptojmë shkakun e koncentrimin të këtij krahu në Egjipt duke lexuar sqarimin e Rafsanxhanit për këtë ide në një intervistë të gjatë prej katërmbëdhjetë vazhdimeve për gazetën iraniene Kihan. Kjo intervistë u botua në gjuhën arabe në një vëllim me titull "Zbulimet e bisedës së çiltër me

Në lidhje me Egjiptin, asnjëherë s'kam menduar që t'i ndërpresim marrëdhëniet me të, mirëpo Imami, ishte ai që urdhëroi të ndërpriteshin marrëdhëniet me të.

Hashim Rafsanxhanin", nga shtëpia botuese "El-Vilaje", në vitin 2005. Në këtë intervistë, mes tjerash, Rafsanxhani thotë: "Në lidhje me Egjiptin, asnjëherë s'kam menduar që t'i ndërpresim marrëdhëniet me të, mirëpo Imami, ishte ai që urdhëroi të ndërpriteshin marrëdhëniet me të. Në kohën e qeverisjes time të parë, në Këshillin e Sigurisë Kombëtare pranuan që t'i rivendosim marrëdhëniet. Në fillim pranoi lideri, Hamnei, mirëpo më vonë refuzoi dhe punët mbetën kështu si janë..."

Tani situata ka ardhur aty ku është dhe tani kanë filluar ta përsërisin atë që unë e thosha që atëherë, se populli egjiptian e do Ehli Bejtin, alejhimusellam, se ne atje posedojmë një bazë shumë të mirë popullore, se Egjipti gëzon ndikim kulturor në Afrikë dhe në shumë rajone, se Az'hari i mëson mësuesit që japin mësim në ato vende, andaj është dashur ta bëjmë këtë hap". (fq. 431)

Nga këto fjalë është shumë qartë se Rafsanxhani ka kuptuar rolin që ka Egjipti në Afrikë dhe në botën Islame, dhe se depërtimi në Egjipt, e sidomos në Az'har paraqet urën përmes të cilës revolucioni iranian do të kalojë te të tjerët!!

Për këtë arsye Hatemi shqyrtoi rikthimin e "shoqatës për afrim" në Kajro dhe ishte e domosdoshme hapja e saj në Teheran.

Përktheu: Bekir Halimi

Fi sebililah

Duhet të jetojmë...

shkruan: Omer BERISHA

Në përgjithësi, janë të paktë ata që flasin për rëndësinë e jetesës si mysliman i mirë, madje ka të atillë, të cilët para se të kuptojnë jetën në Islam flasin dhe trumbetojnë vazhdimisht se si duhet vdekur në rrugë të Allahut.

Sinqeriteti i personit i cili dëshiron të vdes si mysliman do të shihet kur ai mundohet ta kuptojë këtë fe të lartë, ashtu siç e ka zbritur Allahu i Lartësuar dhe ta jetojë në atë mënyrë siç e ka jetuar i dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut i Allahut qoftë mbi të dhe shokët e tij të sinqertë. Mirëpo, kuptimi i drejtë i fesë dhe të jetuarit e saj përmban në vete disa shenja.

Dija e vërtetë

Ky element i rëndësishëm është edhe kushti i parë i fjalës La ilahe il-lallah,

gjegjesisht kushti i parë për të qenë dikush mysliman, meqë vetvetiu shqiptimi i shehadeetit pa pasur njohuri për të, nuk ka asnjë dobi.

Secili mysliman nuk është i detyruar të bëhet hoxhë dhe të studiojë çështjet e jurisprudencës islame, mirëpo secili mysliman e ka për detyrë t'i mësojë çështjet elementare, të cilat do t'i mundësojnë vazhdimësi në këtë rrugë e cila shpie drejt lumturisë së përherëshme, madje edhe në këtë botë.

Prej gjërave elementare që secili besimtar duhet t'i mësojë janë: cili është adhurimi i merituar që ia kemi borxh Allahut të madhëruar, cilat janë veprat që myslimani duhet t'i bëjë, cilat janë gjërat e dëmshme prej të cilave duhet të largohemi dhe më e rëndësishmja: si të jemi të përqendruar në këtë rrugë, me qëllim që frymën e fundit nga kjo botë ta nxjerrim duke qenë besimtarë të denjë, myslimanë të vërtetë.

Dija është gjë e shtrenjtë dhe pikërisht për këtë nuk mund ta gjesht te çdokush. Dija ka rrugët e caktuara andaj nuk mund ta gjejë secili. Mirëpo për fat të mirë, Allahu na ka begatuar

Askush të mos mendojë se e ka për detyrë të punojë më tepër se sa ka mundësi, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë: "Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive që ka".

me këtë fe, e cila na udhëzon në rrugët e sigurta drejt kësaj mirësie (diturisë).

Ku gjendet dija? Dija për të cilën ka nevojë secili besimtar gjendet te pejgamberët, mirëpo, ku mund ta gjejmë atë pas vdekjes së tyre? Përgjigja dihet, por si përkujtim vlen të ceket se I dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka t h ë n ë :

"Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve, trashëgimia e pejgamberëve nuk është dinari, e as dërhem, por DIJA, kush merr dije ai ka marr diçka të madhe". Dijetar i vërtetë është ai për të cilin dëshmon vepra e tij se është dijetar, e pas kësaj padyshim se do të dëshmojnë edhe njerëzit. Gruaja e të dërguarit, Ajsheja, Allahu qoftë i kënaqur me të, për Muhamedin, salallahu alejhi ue selem, dëshmonte kështu: "Sjellja e tij ishte Kur'an". Pra, çdo gjë që



kishte mësuar nga Allahu shihej në sjelljen e tij, në jetën e përditshme. Ndërsa, nuk është dijetar ai që nuk pasurohet me këtë cilësi.

Si fitohet dija? Kur erdhi Xhibrili, alejhi selam, te Resulullahu, paqja dhe bekimi i Allahut i Allahut qoftë mbi të, për t'ia parashtruar disa pyetje të rëndësishme, u ul me një ulje respekti para të dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe filloi t'i parashtronte pyetje, ndërsa besimtarët tjerë dëgjonin... në fund i dërguari i Allahut tha: ky ishte Xhibrili, erdhi me qëllim që t'ua mësojë çështjet e fesë. Nga ky hadith shkurtimeisht kuptojmë se dija duhet kërkuar duke u ulur para trashëgimtarëve të pejgamberëve me respekt dhe duke i dëgjuar ata.

Dija fetare nuk fitohet ndryshe, ajo nuk fitohet në internet, në gazetë, në kasetë, në revistë, e aq më pak në çajtores. Prej këtyre gjërave mund të përfitohet vetëm në aspekt të inkurajimit apo frikësimit, mirëpo assesi nuk mund të bëhet dikush dijetar, madje as nxënës i dijes edhe nëse di arabisht.

Të jetuarit fi sebilil-lah (në rrugë të Allahut)

Jeta e një myslimani të mirë do të dukej kështu: Zgjohet posa ta dëgjojë ezanin e namazit të sabahut dhe pasi të merr abdes dhe t'i falë dy sytetet e sabahut, shkon në xhami, ku i falë

Dija fetare nuk fitohet ndryshe, ajo nuk fitohet në internet, në gazetë, në kasetë, në revistë, e aq më pak në çajtores.

farzet dhe pas namazit lexon lutjet (dhikrin) që bëhen pas namazit. Nëse dëshiron t'i shtojë sevapet, lexon edhe lutjet e mëngjesit. Kohën e lirë midis namazit dhe nisjes për në punë, e shfrytëzon

për lexim të Kur'anit, të ndonjë libri, gazete ditore etj. Shkon në punën e tij, ku punon me korrektësi dhe pa dredhi, madje edhe nëse punëdhënësi është jomysliman, sepse myslimani i qëndron besnik marrëveshjes, përveç nëse ajo e urdhëron për të bërë ndonjë haram apo e ndalon nga ndonjë detyrë fetare. Në rast të tillë të drejtën e tij detyrohet ta kërkojë në mënyrën më të mirë dhe me siguri se të njëjtën do ta fitojë. Kjo gjë tani është bërë realitet dhe e vërejmë në përditshmërinë tonë, përveç në raste të rralla. Kthehet në shtëpinë e tij, ku në tërësi i kushton vëmendje familjes, kujdeset që në shtëpinë e tij të ketë "shariat", (sepse ky është "kryetar, mbret" i këtij "shteti") kujdeset për

nevojat familjare në çdo sferë dhe mundohet që në atë shtëpi të futë lumturinë dhe dashurinë, e jo diktaturën. Gjatë gjithë kësaj kohe mundohet që namazet t'i falë në xhami, ku do të ketë rastin të formojë një shoqëri të mrekullueshme, të cilët do të ndihmohen mes vete në punë të mbara dhe devotshmëri. Por me shumë kujdes, që xhamitë të mos bëhen vende të përgojimit dhe mbjelljes së armiqësisë në mesin e myslimanëve. Dita e këtij myslimani të mirë përfundon

Allahu i Lartësuar thotë: "Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: 'Nuk je besimtar', me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete, ndërkohë që te Allahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e Allahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se Allahu është Njohës i veprave tuaja"

duke e aktivizuar alarmin e namazit të sabahut.

I dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: "Ndaj Allahut, vetvetes dhe ndaj familjes ke detyra. Përmbushi këto detyra ndaj të gjithëve". (Shënon Buhariu nr. 1968)

Ti je më i vogël se Kina

Kjo fjalë më kujton kur gjatë studimeve një dijetar na këshillonte për gjëra mjaft të rëndësishme. Ai, mes tjerash, tregonte për një nxënës nga bota arabe i cili kishte ngecur bukur shumë në mësimet e tij. Jo se nuk ishte i aftë, por për shkak se ishte preokupuar me lexim për problemet e myslimanëve në shtetin komunist të Kinës. Kur një dijetar e këshilloi se ajo që kërkohet nga ai është ta ndërtojë veten me dije të vërtetë dhe pastaj mund të sheh më qartë se në cilën sferë mund t'u bëjë dobi myslimanëve... nxënësi i mërzitur thoshte: Por vëllezërit tanë në Kinë?! Kush do të kujdeset për vëllezërit tanë në Kinë...

Njeriu i mençur duhet ta kuptojë realitetin në të cilin gjendet. Fillimisht duhet të mendojë në aftësitë dhe mundësitë që i ka, e pastaj të ndërmerr hapa konkrete se si ta vazhdojë udhën drejt xhenetit. Askush të mos mendojë se e ka për detyrë të punojë më tepër se sa ka mundësi, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë: "Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive që ka".

Nëse dikush nga besimtarët e rëndomtë sot e ka kuptuar se përçarja është e keqe, nuk kërkohet me automatizëm që të ndërmerr iniciativa për bashkimin e gjithë myslimanëve, sepse

Dija është gjë e shtrenjtë dhe pikërisht për këtë nuk mund ta gjesh te çdokush. Dija ka rrugët e caktuara andaj nuk mund ta gjejë secili.

rrezikon të ndërmerr hapa të cilat do të shkaktojnë edhe më shumë përçarje. Nëse dikush sot e ka kuptuar se gjaku i myslimanëve po nëpërkëmbet në shumë vende të botës, duhet ta dijë se edhe para tij ka pasur njerëz që këtë çështje e kanë mësuar dhe me siguri janë më besimtarë se ai, andaj nuk duhet të ndërmerr hapa të tillë që do të shkaktonin edhe më shumë nëpërkëmbje të nderit dhe gjakut të myslimanëve.

Prandaj, kush dëshiron ta ndihmojë Islamin, le ta ndihmojë nga këndi i tij. Nëse është tregtar, le t'i nxjerr në pah mirësitë e tregtisë Islame, nëse është mësues le të jetë shëmbëlltyrë për nxënësit e tij, madje edhe nëse nuk ligjëron lëndë fetare, nëse është mjek le t'i bindë pacientët e tij se Allahu është i Gjithëfuqishëm dhe se vetëm ai sjell të mirat dhe largon të këqijat, nëse nuk ka punë konkrete le të paraqitet si vullnetar në ndonjë punë bamirëse.

Dallimi mes thirrjes në Islam dhe nënçmimit të njerëzve

Nëse Allahu na ka nderuar që ta kuptojmë dhe jetojmë këtë fe, atëherë e kemi për detyrë t'i lajmërojmë të gjithë njerëzit për këto mirësi. Nëse dikush nuk na kupton, nuk duhet të shpejtojmë për t'i gjykuar, sepse ndoshta nuk jemi duke ua shpjeguar këtë fe ashtu siç i ka hije një pasuesi të Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe

duhet të mos harrojmë se edhe ne dje ishim sikur ata, e ndoshta edhe më të humbur. Me siguri - pas dëshirës së Allahut - në udhëzimin tonë kanë ndikuar fjalët e ëmbla të ndonjë personi, e jo gjykimi i tjetrit se ne jemi bidatxhi, të humbur, kafira, etj. Allahu i Lartësuar thotë: "Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: 'Nuk je besimtar', me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete, ndërkohë që te Allahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e Allahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se Allahu është Njohës i veprave tuaja". (Nisa 94)

Nëse vërtetë dëshirojmë ta përhapim Islamin anekënd botës duhet të ecim pas hapave të njëjtë që Resulullahu, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, i ndoqi në atë drejtim. Te ai, njerëzit mund të shikonin Islam të gjallë dhe lumturi e hare në atë lloj jetese, e më vonë e kuptonin se këto mirësi nuk mund të arrihen përveç nëse do të jetonin si besimtarë të vërtetë.

Prej drejtësisë është që kjo mirësi të jetë e ofruar për secilin njeri në botë. Këtë gjë e kuptuan shokët e Resulullahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dhe shkonin në çdo vend për ta përhapur këtë mirësi. Nëse dikush i pengonte në predikimin e kësaj feje, atëherë xihadi në rrugë të Allahut ishte mjeti (lexo: mjeti) më i mirë që ndihmonte përhapjen e dijës Islame dhe secili që kishte arsye të

shëndoshë hynte në të pa kurrfarë dhune.

Vdekja fi sebilil-lah (në rrugë të Allahut)

Përfundimi i jetës si mysliman i mirë është një mirësi, vlerë dhe kënaqësi e papërshkrueshme. Këtë mirësi, Allahu do t'ia mundësojë vetëm atij që jeton një jetesë islame me sinqeritet. Është mirë, që secili besimtar të shpresojë vdekjen si shehid (dëshmor), për shkak të vlerave të mëdha që ka. Resulullahu paqja dhe bekimi i Allahut i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Pasha Atë, në dorë të Cilit është shpirti im, kam dëshirë të luftoj në rrugë të Allahut dhe të vritem, pastaj të ngjalle dhe sërish të vritem, të ngjalle dhe sërish të vritem". (E shënon Buhariu nr. 7227)

Mirëpo, kjo gjë nuk iu mundësua një numri të madh të myslimanëve të mirë gjatë historisë, madje as Resulullahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Pra, e jona është që të shpresojmë, por Allahu e di çka është më mirë për ne.

E lus Allahun e Madhëruar të na ndihmojë në jetësimin e Islamit dhe vdekja të na gjejë duke dhënë kontributin tonë për këtë fe.

Bisedën time do ta përfundoj me fjalinë: Nëse dëshirojmë të vdesim fi sebilil-lah, duhet të jetojmë fi sebilil-lah.

Kthehet në shtëpinë e tij, ku në tërësi i kushton vëmendje familjes, kujdeset që në shtëpinë e tij të ketë "shariat", (sepse ky është "kryetar, mbret" i këtij "shteti") kujdeset për nevojat familjare në çdo sferë dhe mundohet që në atë shtëpi të futë lumturinë dhe dashurinë, e jo diktaturën.

Çka të pëlqeu te muzika?!

17



"Do të ketë nga umeti im që do ta bëjnë hallall marrëdhënien jashtëmartesore, mëndafshin, verën dhe instrumentet muzikore" d.m.th. të gjitha këto janë të ndaluara por do të vijë një kohë ku dikush do t'i bën të lejuara.

Të nderuar vëllezër e motra

Koha po kalon, vallë nuk e meritojmë të ndalemi disa çaste të flasim me fjalë të buta dhe shprehje nostalgjie. Vëlla e motër ju lus që mos të bëheni koprrac ndaj meje me lexim të këtij artikulli duke i ndarë pesë minuta nga koha e juaj e çmuar. E kush nuk është i gatshëm tani për lexim le t'i shtypë (printon) këto fjalë e le ti lexojë më pas, ngase këto fjalë meritojnë kujdes të veçantë. Vëlla e motër ... O ju që dëgjoni muzikë ... Shkronjat e mia ju thërrasin me shpresë. Mos thoni nuk kemi dobi edhe nëse e përsërit këtë këshillë por duke e thënë të vërtetën thoni po, do të heshtim para thirrësit

të vërtetë. I mençur është ai i cili e njeh hakun dhe e pranon atë ndërsa injorant është ai i cili i mbyll sytë para hakut... Haku gjithnjë shndritë kurse gënjeshtria fundoset.

Mirë, t'ia fillojmë...

A nuk e ke vërejtur vëlla i dashur apo motër e dashur se: Kur ka dëgjuar dikush nga ju muzikë një periudhë të gjatë trupi i tij është në dridhje dhe reaksion nga këto këngë andaj gjysmë ore nuk mund të ulet e të dëgjojë diçka nga kur`ani duke e ditur se ai është shërues i zemrave, udhëzues i njerëzimit, libër qiellor, dritë dhe hair i gjithë njerëzimit. A e ke pyetur veten

Artikuj

ndonjëherë?! Pse këngët zënë vend te ti dhe i dëgjon ata, a të vjen rëndë që të ulesh të dëgjosh e të meditosh mbi kur'anin? Allahu xh.sh në kur'anin famëlartë thotë: "Shejtani ua ka zbukuruar veprat e tyre". Kjo është e vërtetë. Kjo është ajo për të cilën ju thërras që të jemi të qartë.

Fatkeqësi është ta tradhtosh vetveten, sepse me të dëgjuarit e muzikës largohesh nga të përmendurit e Allahut e ajo ta ngushton jetën. Allahu subhanehu ue teala, thotë: "Kush ia kthen shpinën Kur'anit tim do t'i japim atij jetë të ngushtë (plot halle, vështirësi të parehatshme) dhe do ta ngjallim ditën e kiametit të verbër" TA HA 124.

E vërteta e këngëve është se ato janë dhimbje dhe dëshpërim. Edhe pse duket se ka njëloj dëfrimi por ai dëfrim është i falsifikuar nga djalli. Atëherë dëgjon fjalën e Allahut lidhur me Iblisin (djallin) e mallkuar: "Dhe me atë alarmin e zërit tënd, mashtroje atë që mundesh prej tyre, me kalorësit e këmbësorët tuaj thirri (bërtitu) ata, përzieju me ta në pasuri dhe në fëmijë dhe premtouj atyre! Por, shejtani nuk u premtouj tjetër, përveç mashtimit".

Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, thotë: qëllimi në këtë ajet është për muzikën. Muxhahidi thotë: për muzikën dhe fjalët e kota. Kurse Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, thotë: Prej tradhtive të iblisit është se ai i mashtron ata që janë të dobët në dije, logjikë dhe fe, e ua rrëmben mendjen dhe i bën që ata të merren me muzikë,

fishkëllima dhe duartrokitje që t'i pengojnë zemrat nga Kur'ani e t'i kthejnë nga shfrenimi dhe urrejtja, e ai është Kur'ani i iblisit, perde e sheshtë (e fortë) prej Kur'anit dhe magji e zinasë, me të cilën mëkatari ia arrin qëllimit të vet, si dhe të keqen ua zbukuron që t'u duket e mirë, kështu që Kur'ani mbetet larg tij. Ky dëfrim i rrejtshëm dhe ky gëzim i falsifikuar kalon shpejt, por mëkati mbetet i regjistruar në regjistrin e veprave të tij, sepse muzika është shpalosje e mëkateve të njeriut. Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: "Umetit tim i falen mëkatet,

Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: "Hyritë do të këndojnë në xhenet. Do të thonë: Ne jemi hyri të bukura, jemi bërë gati për burrat e ndershëm".

pos atyre të cilët i shpalosin mëkatet e veta". E disa krenohen me muzikë dhe e mbajnë kokën lartë. Krenohen me mëkatin që ia kanë bërë Allahut. Dikush thotë ky është këngëtarim, kjo është këngëtarja ime.

A nuk e dinë ata se ditën e ringjalljes do të ringjallen me ata të cilët i kanë dashur

në këtë botë. Disa prej tyre janë të mashtruar nga djalli duke e quajtur muzikën si art apo edukues i gjeneratave. Por nëse i dëgjon vetëm fjalët, atëherë e kupton se ajo është porosi e djallit të mallkuar meqë të shpie nga e keqja. Shumë është e qëlluar fjala e atij i cili e ka quajtur muzikën si magji dhe postë të zinasë.

O bijtë dhe bijat myslimane... Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që ta pastrojmë shpirtin: "Ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten". Muzika nuk është tjetër pos padrejtësi që ia bën shpirtit që Allahu ta ka dhuruar dhe

Ky dëfrim i rrejshëm dhe ky gëzim i falsifikuar kalon shpejt, por mëkati mbetet i regjistruar në regjistrin e veprave të tij, sepse muzika është shpalosje e mëkateve të njeriut.

për të cilin të ka urdhëruar ta pastrosht. Pra, liroje atë nga mëkatet dhe epshet, e mos e mashtro atë me muzikë sepse në këtë mënyrë i ke bërë padrejtësi shpirtit tënd.

Allahu subhanehu ue teala, thotë: "Ai nuk i shpëton zullumqarët". Dhe thotë: "Po ka nga njerëzit që blejnë tregime boshe e me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së Allahut pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato (ajetet) si tallje. Për ata sigurisht është përgatitur dënim i turpshëm". LUKMAN 6

Abdullah b. Mesudi është betuar se qëllimi në këtë ajet është muzika.

Muhamedi salallahu alejhi ue selem, duke na sqaruar dhe duke na e tërhequr vërejtjen nga kjo sëmundje thotë: "Do të ketë nga umeti im që do ta bëjnë hallall marrëdhënien jashtë-martesore, mëndafshin, verën dhe instrumentet muzikore" d.m.th. të gjitha këto janë të ndaluara por do të vijë një kohë ku dikush do t'i bën të lejuara.

Pastaj në hadithin tjetër thotë: "Pa dyshim se do të ketë njerëz nga ky ummet që do ta pinë alkoolin, të cilin do ta emërtojnë me emra tjerë. Ata do të dëfrehen edhe me muzikë dhe këngëtare. Këta njerëz do t'i lëshojë toka dhe do t'i shndërrojë Allahu në derra dhe majmuna". Albani thotë se ky hadith është i vërtetë. Të mos thotë dikush se muzika e qetë është e lejuar. Apo, dikush të thotë se këngët patri-

otike me muzikë janë të lejuara, sepse argumentet që e ndalojnë këtë janë shumë të qarta.

Pastaj duhet ta dish se për të hollat dhe kohën që e ke harxhuar për muzikë do të japësh llogari, sepse as lodra e as shkopi i lodrës nuk do të bëjnë dobi ditën e gjykimit përpos veprës së mirë.

Pra, a je përgatitur që të takohesh me Allahun?!

Në fund... Secilit që ka vendosë të pendohet dhe të kthehet te e vërteta, ia dërgoj këtë përgëzim. Për atë që ka vendosur të heqë dorë prej muzikës dhe i pastron veshët e tij nga kjo sëmundje.

Ta dërgoj këtë përgëzim, lexo fjalën e Allahut: "Dhe ditën kur do të ndodhë kiameti, atë ditë do të ndahen (njerëzit). E ata të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, ata do të jenë të gëzuar në një kopsht (të xhenetit)" ER-RUM 14-15. Fjala "të gëzuar" në këtë ajet është shprehur me fjalën "juhberun", e cila fjalë tekstualisht d.m.th. kënaqësi dhe dëgjim. Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut ofhtë mbi të, thotë: "Hyritë do të këndojnë në xhenet. Do të thonë: Ne jemi hyri të bukura, jemi bërë gati për burrat e ndershëm". Albani thotë se ky hadith është i vërtetë.

Dijetari i famshëm Ibën Kajimi, nga ana tjetër, i ka radhitur fjalët e Ibën Abasit në disa vargje të mrekullueshme, ku Ibën Abasi thotë:

Zoti ynë dërgon erën që dridhë balluket e palëvizshme

Që shkaktojnë zëra që prekin të dëgjuarit e njeriut

Sikur tingujt e peshuar

Oj kënaqësi e dëgjimit mos u adapto me

*kënaqësinë e dalë nga telat dhe lahuta
për të dëmtuar dëgjimin ashtu siç zem-
rën e dëmtojnë të kënduarit dhe sikleti
pastroje të dëgjuarit tënd nëse dëshiron
të dëgjosh zërin e tyre (hyrive)*

*se në zemrën e robit asnjëherë nuk bëhen
bashkë dashuria e Kur'anit me dashurinë e
melodisë së këngës.*

*Vallahi dëgjimi i tyre për zemrën dhe
imanin është sikur helmi për trupin.*

Dikush nga ju mund të pyes si të largohem prej muzikës, duke pasur parasysh se unë e kam bërë shprehi që të dëgjoj muzikë e nuk mund të largohem lehtë? Atëherë ndiqi këto këshilla - e nëse do Allahu - do të fitosh:

1- Të bëhesh i sinqertë në pendim dhe qëllime të pastra si dhe të kesh trimëri, sepse ky vendim kërkon edhe trimëri

2- T'i shkatërrosh të gjitha kasetat që i posedon

3- Nëse epshi të nxit që të dëgjosh muzikë atëherë shpejto dhe merre mus'hafin dhe lexo që ta qetësosh shpirtin, e nëse nuk mundesh atëherë dëgjo ndonjë kasetë Kur'an apo ndonjë ligjëratë të incizuar nga ndonjë hoxhë

4- Nëse dikush tallet me ju se nuk po dëgjoni muzikë mos iu kundërvë por thuaj: "Allahu të shpërbleftë" apo "Allahu të udhëzofte", etj. sepse kjo fjalë e lë pa tekst atë, ndërsa juve ju qetëson.

5- E nëse dikush nga familja juaj dëgjon muzikë sqarohu atyre në mënyrë të edukuar duke u dhuruar ndonjë libër apo kasetë qoftë Kur'an apo ligjëratë dhe ua bën me dije se

dëgjimi i tyre edhe ty të pengon, sepse e ndien veten i vetmuar dhe larg prej tyre.

Vëlla e motër

Dijeni se, nëse jeni të sinqertë në pendim dhe ia mbyllni të gjitha shtigjet shejtanit është shumë lehtë që të largoheni nga kjo sëmundje. E mos të thotë dikush do të pendohem pas kësaj kasete, e dikush pas disa ditësh, e dikush pas disa muajsh, sepse iblisi një ditë ta bënë dy, një muaj dy, një vit dy e kështu me radhë.

Sa e sa vëllezër e motra janë të pavetëdijshëm ndërsa buzët e tyre rregullisht i përsërisin këngët që i kanë dëgjuar dhe gjuhët e tyre nuk mundin ta përmendin Allahun.

Kush e len një gjë vetëm për hir të Allahut, Allahu ia zëvendëson me diçka më të mirë se ajo.

Vëlla e motër

Nëse dikush nga farefisi juaj dëgjon muzikë këshillojeni atë. E nëse nuk ju përgjigjet atëherë duhet të largoheni nga ai ambient. Dhe mos të thotë dikush më mjafton mua të pendohem e nuk ndikon ai tek unë. Ruajeni veten tuaj prej vendeve të ndyra dhe degjeneruese dhe shpejtoni me teube nga momenti kur ta lexoni këtë artikull dhe mos thoni "Pastaj" sepse fjala pastaj është nga armët e shejtanit.

Marrë nga: www.saaidd.net

Përktheu: Enver Azizi

shkruan: **Lulzim SUSURI**

Buzëqeshjet mbjellin dashuri, lumturi, respekt dhe harmoni. Në ato familje ku ekziston buzëqeshja mbretëron qetësia. Në shoqëritë ku mbretëron ajo, veçse ka mbretëruar begatia. Bisedat e shoqëruara me të janë të kurorezuara me mëshirë nga Zoti. Përshëndetja e shoqëruar me buzëqeshje vetvetiu tregon shumë më tepër se sa disa orë të kaluara në bisedë. Nëse dëshiron të buzëqeshin të tjerët atëherë, edhe ti buzëqeshu atyre. Mbill respekt dhe dashuri tek fëmijët me buzëqeshje. Edukoi, mësoi, bisedo dhe loz me ta, por vetëm duke buzëqeshur. Shikimet ledhatuese, bisedat, dashurinë bashkëshortore përcilli me buzëqeshje. Vëllain takoje, bisedo dhe përcille vetëm duke i buzëqeshur.

Buzëqeshja, është magji e cila thyen kufijtë e inatit dhe të nervozes, si dhe depërton brenda në thellësitë e zemrës. Arrin aty ku nuk mund të depërtojë asgjë, as edhe shigjeta e pushka.

Pse nuk buzëqesh?! A thua, një vepër e tillë kushton të holla dhe lodhje?! Apo mos vallë është më e shtrenjtë se rezultati i saj?! Pa kurrfarë të hollash, por vetëm duke mbledhur faqet pak nga prapa dhe ia arrin qëllimit. Por, ke kujdes mos të harrosh ta shoqërosh këtë lëvizje me sinqeritet.

Kaq të kushton e asgjë tjetër, për të dhënë lëmoshë. "Buzëqeshja në fytyrën e vëllait tënd është sadaka", këtë mos e harro kurrë! Bëje sa më shpesh që të arrish t' i thyesh kodet e zemrave të miqve dhe armiqve tu.

Pse? Pse besimtari të mos buzëqesh? Pse ai e takon vëllain e tij me fytyrë të mërrrolur dhe buzë të varura?! A thua vallë ka bërë diçka që meriton një sjellje aq të pahijshme dhe të ndaluar me të. Apo, mos vallë shkak i kësaj është përtesa, por pse për një buzëqeshje sadaka?!

Buzëqeshi atij që e njeh dhe që nuk e njeh, sepse ajo nuk sjell dëm por vetëm dobi, nuk krijon përçarje por vëllazëri, miqësi, e jo armiqësi. Nevojtarin prite dhe përcille vetëm duke buzëqeshur madje edhe nëse nuk mund ta ndihmosh ngase, ndonjëherë është më e vlefshme se vet ndihma e tij. Buzëqesh o mysliman. Trego se ti di të buzëqeshësh dhe feja ta mëson atë. Mësoi të tjerët se cila është buzëqeshja e vërtetë, si është ajo para syve dhe pas shpinës. Buzëqesh, për hir të Allahut që tu tregosh të tjerëve se di të buzëqeshësh, e se ti nuk je i vrazhdët, rrugaç, e as terrorist. Buzëqesh gjithmonë sepse ajo tregon edukatën e zemrës sate ashtu siç ndikon në përmirësimin e saj.

Edhe kur të bëhet një padrejtësi sërish buzëqesh që në aspektin psikik ta luftosh tjetrin. Kurrë mos qaj para armikut, e as mos bërtit, meqë një gjë e tillë e gëzon, trimëron dhe kënaq. Por, buzëqesh kinse me ty asgjë nuk ka ndodhur, kinse i ke punët mirë dhe nuk ke aspak telashe. Vepro kështu edhe kur je në vështirësitë më të mëdha sepse nëse vepron të kundërtën, vallë mendon se tjetri do të mëshirojë?! Andaj, buzëqesh dhe vetëm buzëqesh...



Kriteret e të mençurve (2)

Dr. Kha'fer SHEJH IDRIS

2. Dëshmitë e shqisave

A. Të gjithë njerëzit, në shumicën e rasteve u binden dëshmime të shqisave, besojnë se atë që e kanë parë me sytë e tyre, apo e kanë dëgjuar me veshët e tyre, e kanë prekur me lëkurën e tyre, e kanë nuhatur me hundën e tyre apo e kanë shijuar me gjuhën e tyre, është ashtu si e kanë paraqitur shqisat e tij.

Në disa raste, për shkak të ndonjëres prej shumë arsyeve, ndodh që ata të mos

e pranojnë të vërtetën e dëshmuar me shqisa, edhe pse kjo sjellje është në kundërshtim me arsyen e shëndosh. Për këtë shkak Allahu, subhanehu ve te'ala, e kritikoi sjelljen e tillë: "Edhe sikur të zbritnim ty një libër të shkruar në letër,

Kur'ani Famëlartë është libër që nuk mund të lexohet pa shikim dhe dëgjim, dy prej shqisave që i ka njeriu. Ajo që vlen për Kur'anin vlen edhe për dijet e ndryshme.

e ta preknin atë me duart e tyre, ata që mohuan do të thoshin: "Kjo nuk është tjetër përveç një magji e qartë" (El En'am, 7)

Megjithatë një numër i vogël i dije-tarëve myslimanë dhe jomyslimanë qartë i shprehin dyshimet e tyre rreth dëshmisë së shqisave. Prej tyre është Ebu Hamid El Gazaliu, Allahu e mëshiroftë, i cili në librin e tij "Shpëtimtari nga lajthitja" thotë: "Fillova të angazhohem seriozisht me vështrimin e gjërave të kapshme me shqisa dhe gjërave esenciale (të domosdoshme), që të shoh nëse ka vend për të dyshuar në to. Pas vështrimit të gjatë, kritik, arrita në përfundim: Nuk mund të besoj me shpirt të qetë as në gjërat që perceptohen me shqisa. Dyshimi filloi të rritet..."

"Nga vjen kjo bindje në dëshmitë e shqisave, prej të cilave më e fortë është shqisa e shikimit? Njeriu e shikon hijen dhe e sheh atë të palëvizshme, dhe në bazë të asaj që e ka perceptuar thotë: Hija nuk lëviz, që më vonë të njëjtën ta sheh në formë të ndryshme dhe të pohon se hija lëviz por gradualisht, atom pas atomi dhe e ndryshon formën e saj. Situatë e ngjashme është edhe me planetët që i shikon njeriu e që na dukën të vogla që më vonë me shkenca të ndryshme të vërtetojmë se ato janë shumë më të mëdha se sa shihen me syrin e njeriut. Këto gjëra shqisat i gjykojnë sipas dispozitivave të tyre edhe pse në shumë raste kundër tyre gjykon logjika me një gjykim që assesi nuk mund të mohohet. Me këtë asgjësohet besueshmëria e

plotë ndaj shqisave.

Për këto fjalë të El Gazaliut unë kamë disa vërejtje:

1. Nëse mohojmë besueshmërinë e shqisave atëherë nuk do të ishte e saktë se atë që ti e ke parë si hije ta quajmë hije, e as atë që e ke parë si planet ta quajmë planet.

2. Si e vërejte lëvizjen e hijes? Me shikim drejt saj pas një kohe. Kështu ti e ke përdorur shqisën që të përmirësosh gabimin e pohuar për palëvizshmërinë e hijes.

Shumë nga sendet që ne i shohim si të ngurta ne esencë janë fluide dhe përbëhen nga atome që lëvizin në hapësirën e tyre.

Atëherë kur ne e shohim përfundimin ose lindjen e diellit, ai vetëm se ka përdorur ose lindur para tetë minuta.

3. Shikimi si shqisë mjafton si argument për të vërtetuar madhësinë e planetit, sepse gjithë janë të bindur se gjërat në largësi duken më të vogla sesa janë realisht. Më vonë ata zbuluan përpjesëtimin (proportionin) mes largësisë dhe madhësisë.

4. Ndoshta do të thuash ata këto gjëra i kuptuan me fuqinë e logjikës. Po, por më thuaj vallë, a kanë shqisat mundësi të punojnë pa ndihmën e logjikës dhe a ka mundësi që logjika të vepron pa ndihmën e shqisave?

B. Dëshmia e shqisave, për besimtarin mysliman, është fakt i mbështetur prej fesë ashtu si mbështetet edhe nga mendja. Në Islam ka baza që nuk mundën të besohen ashtu siç duhet, e as të veprohet me to, nëse nuk pranohet dëshmia e shqisave.

Kur'an'i Famëlartë është libër që nuk mund të lexohet pa shikim dhe dëgjim, dy prej shqisave që i ka njeriu. Ajo që vlen për Kur'anin vlen edhe për dijet e ndryshme. Namazi, agjërimi, haxhi, njohja e kohëve të tyre mbështetet

plotësisht në dëshmitë shqisore. Këto janë vetëm disa shembuj që vërtetojnë obligimin e besimit në të vërtetat shkencore të dëshmuara me shqisa si për shembull faktin se toka është e rrumbullakët. Në të vërtetat shkencore me siguri nuk merr pjesë teoria e Darvinit.

C. Sidoqoftë shqisat nuk na japin dije gjithëpërfshirëse për atë që e perceptojmë. Ato na japin vetëm dije për disa pasqyrimë të asaj që vështronet. Këto fakte edhe pse të pjesshme na mjaftojnë në angazhimet tona fetare dhe atyre që i përkasin kësaj bote. Shumë nga sendet që ne i shohim si të ngurta ne esencë janë fluide dhe përbëhen nga atome që lëvizin në hapësirën e tyre. Atëherë kur ne e shohim perëndimin ose lindjen e diellit, ai vetëm se ka perënduar ose lindur para tetë minuta. Shumë nga planetët dhe yjet që ne i shohim në hapësirën qiellore vetëm se janë zhdukur dhe ne i shohim vetëm refleksionet e dritës së tyre, të cilave u duhen mijëra vjet për të arritur në tokë. Këta

trupa qiellorë që janë larg planetit tonë ne i shohim atëherë kur drita e tyre përthyeret në syrin tonë. Këtë e kemi vërtetuar me instrumentet e shkencës moderne. Për atë yll ose planet ne e shohim historinë e jo të tashmen e tij.

Në veprimet tona ditore ne mbështetemi në realitetin ashtu siç e perceptojmë. Kohërat e namazit, agjërimit dhe haxhit nuk mbështeten në të vërtetat astronomike, por mbështeten në perceptimin njerëzor.

Disa të rinj me treguan për një konferencë në Britani në të cilën një

shkencëtar pretendonte të argumenton kundërshtimin e Islamit me shkencën moderne, me faktin se myslimanët besojnë që dielli është ai që lëviz në kohë që toka është e palëvizshme. Këtë ai e argumentonte me librat e fikhut ku thuhet se koha e sabahut për shembull është pas agimit dhe para se të "lind" dielli, koha e drekës është kur dielli "lëviz" prej zenitit dhe kështu me radhë. Thoshte: Po të besonin njerëzit në të vërtetat shkencore (për lëvizjen e planetëve rreth diellit) nuk do të përdornin termin lindi dielli ose perëndoi dielli? Atë që ai mundohet ta mohon (përdorimin e këtyre termeve) tek shkencëtarët e astronomisë quhet lëvizje e dukshme e diellit, dhe ne si të tillë i përdorim këto terme në jetën tonë të përditshme.

Nga këto dy ajete ne kuptojmë se shkaku i pamundësisë për të parë Allahun në këtë botë është natyra e syrit njerëzor, jo natyra e qenies hyjnore e cila nuk ndryshohet në kohë që gjendja e shqisave tona ndryshohet.

Ç. Paaftësia jonë për t'i parë gjërat ashtu siç janë, ndoshta është një formë e manifestimit të mëshirës së Allahut, subhanehu ve te'ala, ndaj neve.

"Dhe (përkujto) kur Allahu t'i dëftoi ty ata në ëndërr, të paktë në numër, e sikur t'i dëftonte shumë, ju do të dobësoheshit e do të grindeshit për çështjen (e luftës), por Allahu ju shpëtoi. Allahu vërtet e di shumë mirë se ç'mbajnë kraharorët (zemrat). Kujtoni kur u takuat (në sheshin e luftës), e Ai bëri që ata në sytë tuaj të duken pak, e po ashtu edhe ju të dukeni në sytë e tyre pak; e bëri këtë për ta zbatuar Allahu një çështje që ishte e vendosur. Vetëm te Allahu është përfundimi i çështjeve." (El Enfal, 43-44)

"Ju (çifutë) patët një përvojë të madhe në ato dy grupe që u konfrontu- at ndërmjet vete. Njëri grup luftonte në rrugën e Allahut, e tjetri ishte jobesim- tar, dhe me shikimin e syve të tyre i shi- hnin se ishin dy herë më shumë se bes- imtarët. Po, Allahu me ndihmën e vet përforcon atë që do." (Ali Imran, 13)

D. Disa mosbesimin e tyre, e argu- mentojnë me mohimin e gjërave që nuk i shohin: "Dëftona Zotin sheshas" (ta shohim me sy)" (En Nisa 153)

Disa të tjerë pretendojnë se një qasje e tillë është e patjetërsueshme në metodologjinë shkencore. Gënjen. Po të ishte ashtu, ata do të duhej t'i moho-jnë ndodhitë historike (që nuk i kanë parë), do të detyroheshin të mohojnë gjërat që ekzistojnë në vende të ndryshme, e që janë të pakapshme për shqisat tona. Do të bëheshin si filozofët që thoshin: I besojmë gjërat derisa i shohim sepse nuk e dimë a mbeten në ekzistencë pasi që t'i mbyllim sytë ose lakojmë shikimin? Disa të tjerë janë të mendimit se shqisat janë të afta për të kapur gjërat që kanë natyrë materiale dhe me këtë qëndrim ata argumentuan pamundësinë për të parë Allahun, sub- hanehu ve te'ala, sepse asgjë nuk është si Ai, dhe sytë e njeriut nuk mundin të shohin përpos atë që është e krijuar. Me këtë qëndrim ata bëjnë disa gabime:

I pari: Mundësia që sendet e krijuara të shihen nuk është argument se nuk ka gjëra të krijuara që nuk shihen. Të thuash: Krijesat e këtij lloji shihen, është përkufizim më përcaktues se sa të thuash: Krijesa të vetme janë ato që shi- hen.

I dyti: Të gjithë dimë për ekzistimin e sendeve që nuk mund të perceptohen me shqisat pa mjete ndihmëse. Me

teleskop shihen sende në largësi të madhe që ne nuk mund t'i shohim vetëm me syrin tonë. Në ndihmë për t'i parë sendet e imëta na del mikroskopi. Po të gjykonim me logjikën e tyre ato nuk do të mundej të shihen sepse, sende që shihen sipas tyre janë vetëm sendet që i sheh syri pa ndihmë.

I treti: Po! Ne nuk e shohim Allahun në këtë dynja. Për këtë shkak kur Musa, alejhi selam, bëri lutje: "Zoti im! Ma mundëso pamjen tënde e të shikoj!" (El A'raf, 143) Allahu iu përgjigj me këtë fjalë: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh, por shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shohësh Mua" (El A'raf, 143).

Nga ana tjetër, në Ahiret, besimtarët do ta shohin Allahun: "Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë." (El Kijame 22-23)

Nga këto dy ajete ne kuptojmë se shkak i pamundësisë për të parë Allahun në këtë botë është natyra e syrit njerëzor, jo natyra e qenies hyjnore e cila nuk ndryshohet në kohë që gjendja e shqisave tona ndryshohet. Pamundësia për të parë sendet e largëta dhe të imëta, nuk është pasojë e natyrës së tyre por e natyrës së shqisave. Ashtu siç për- forcohen mundësitë e shqisave tona në këtë botë me mjete të ndryshme dhe ato i shohin sendet që normalisht nuk kanë mundësi t'i shohin, ndryshim i ngjashëm do të ndodh edhe në botën tjetër në të cilën natyra e njeriut do të dallon nga natyra e kësaj bote dhe me ndryshimin e natyrës do të ndryshojnë edhe shqisat.

Përktheu: Talha Kurtishi



Konflikti ideologjik mes të vërtetës dhe të kotës (1/3)

Abdullah EL-XHERBUË

Bota, para se të vijë Islami, lundronte nëpër ideologji shumë të ndryshme. Këto ideologji që çonin drejt humbjes dhe mospajtimit që rezultonte si pasojë e tyre ishin nga shkaqet kryesore që sollën njerëzimin deri në luftëra, humbje dhe përçarje.

Mendimtari Sejid Kutub ka thënë: "Islami erdhi përderisa në botë kishte një grumbull të paparë të besimeve, pasqyrimeve, filozofive, përrallave, ideologjive, supozimeve, shenjtërimeve, traditave dhe situatave ku përzihej e vërteta dhe e kota, e shëndosha me të sëmurën, feja me besëtytninë dhe filo-

zofia me përrallat...

Mendja njerëzore - në gjendjen në të cilën ishte - ecte kuturu nëpër errësira dhe supozime e assesi të ndalonte në ndonjë bindje. Jeta njerëzore pa ndaluar shkonte drejt prishjes dhe dekadentizmit, padrejtësisë dhe nënçmimit, fatkeqësisë dhe dëshpërimit. Gjë, në të cilën nuk duhet të jetë njeriu, madje edhe shumë prej kafshëve".¹

Vetë njeriu - me logjikën e mangët dhe dijen e kufizuar - ishte burimi kryesor i këtyre ideologjive kuturu. Askush - përveç pasuesve të pejgamberëve - nuk mbështetej në thelb të fortë dhe

mendime të shëndosha, që do t'u siguronin ecje të sigurt drejt qëllimeve të caktuara.

Hamendja, besëtytnia, supozimet, epshet dhe zbulurimet që djajtë i bënin në mendjen e njerëzve ishin shkaqet kryesore në shpikjen dhe zhvillimin e atyre ideologjive që mbisunduan kokat e njerëzve, atëherë por edhe sot.

Nuk ka dyshim se injoranca dallon nga vendi në vend, varësisht nga faktorët që ndikojnë te mendja e njerëzve.

Mund të themi se injoranca më e lehtë ka qenë ajo e arabëve para se të vijë Islami. Themi kështu, sepse ajo nuk ishte e ndërnuar mbi mashtrime logjike dhe zbulurime filozofike. Tek ata nuk gjendej besimi në reinkarnacion (rimishërim) apo inkarnacion (mishërim). Besimi i tyre ishte në hamendje, besëtytni dhe tradita të këqija ose të mira. Imitonin prindërit e tyre pa përdor logjikën dhe i çmuuan aq shumë, derisa këto gjëra u bëjnë fe e pandarë për ta.

Krahas kësaj injorance, ata ishin më afër natyrshmërisë (fitre-së) dhe me injorancë më të lehtë sesa të tjerët. Kjo siç duket ka qenë edhe një nga shkaqet - krahas gjuhës së pastër, kuptimit të drejtë të fjalëve dhe besimit në zotërimin e Allahut² - që Allahu i zgjodhi si popull për ta bartë Porosinë e Allahut.

Sa i përket shoqërive ku ishin të përquendruara kulturat e hershme dhe filozofët, te ata injoranca ishte më e thellë dhe më e gjerë. Sepse filozofët hartuan besime siç u thoshte mendja e tyre dhe i zbuluruan. Po ashtu, thurën argumente, arsye dhe përralla të cilat ndikonin në përhapjen e atyre besimeve te njerëzit. Me kalimin e

kohës, këto ideologji u bëjnë fe të shenjta dhe u zgjeruan si rezultat i mospajtitimit të atyre filozofëve.

U shfaqën shkollat greke në Greqi, u shfaq lloj-lloj feje hinduse, persiane, kineze dhe egiptiane, të cilat ndikuan edhe në dy fetë qiellore, në judaizmin dhe në krishterimin, e po ashtu, edhe shumë besime të këtyre dy feve u përhapën te këto fe politeiste dhe te filozofët, si rezultat i përzierjes së njerëzve nëpërmjet shpërnguljeve, tregtisë, etj.

Jeta njerëzore pa ndaluar shkollat drejt prishjes dhe dekadentizmit, padrejtësisë dhe nënçmimit, fatkeqësisë dhe dëshpërimit. Gjë, në të cilën nuk duhet të jetë njeriu, madje edhe shumë prej kafshëve.

Kjo ishte gjendja e njerëzimit kur i erdhi Shpallja Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, për fenë e drejtë dhe të lartë, që është në kulmin e pastërtisë dhe qartësisë.

Aty gjendet sqarimi i plotë për gjithçka që ka nevojë njerëzimi në realizimin e rolit të tij në tokë: si zëvendës i Allahut, të qenit rob i Tij dhe arritja e lumturisë në dynja (botë) e ahiret (amshim).

Kjo Porosi Hyjnore u dallua me atë se përmbledh çdo gjë që ka nevojë njerëzimi, përfshin secilin njeri, në çdo vend dhe çdo kohë. Ajo bartë njoftimin e drejtë me Allahun dhe me detyrat ndaj Tij, na njofton me gjithësinë, jetën dhe me njeriun, rolin e tij në jetë dhe përfundimin e tij pas vdekjes.

Ajo bartë sistem të plotë dhe të drejtë për lidhjen e njerëzimit me Krijuesin dhe lidhjen e krijesave mes vete. Ai thotë: "Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kurani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugët e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e

drejtë". (Maide 15, 16)

Kjo përfshirje i mundëson individit dhe shoqërisë baraspeshën dhe ujdinë midis logjikës, shpirtit dhe punës, gjë e cila është nga faktorët kryesorë për një jetë të lumtur frytdhënëse.

"O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë". (Enfal 24).

Kjo Porosi ishte mëshirë nga Allahu për njerëzimin, që t'i lirojë nga injorancat të cilat kapluan zemrat e tyre dhe i ndynë mendjet e tyre për një kohë të gjatë.

Resulullahu salallahu alejhi ue selem, jetoi në Medinë duke themeluar shoqërinë Islame dhe duke i drejtuar të gjitha çështjet sipas rrugës së Zotit. Ai nuk u shpërngul nga kjo jetë, përderisa nuk arriti që Islami, plotësisht, të personifikohet në realitet të gjallë. Të shihen mirësitë e Islamit dhe të jep rezultate në mendime, zemra dhe sjellje.

Pasi ndërroi jetë, halifët e drejtë edhe më shumë e përforcuan këtë realitet dhe zgjeruan ndikimin e tij nëpërmjet çlirimeve Islame. Nxitonin drejt kësaj që t'i lironin njerëzit nga injoranca dhe pasojat e saj. Brenda pak viteve, myslimanët arritën të lirojnë shumë popuj nga qeveri dhe ushtri, të cilat i pengonin njerëzit nga drita e besimit. Pra, shumë njerëz grupe-grupe pranonin Islam, ndërsa siguria dhe drejtësia zuri vendin e frikës, zullumit dhe diktaturës. Shiheshin qartë rezultatet e besimit të pastër dhe mësimave të drejta. Njerëzit fituan logjikë të qartë, të menduar, të shëndoshë, qetësi në zemër dhe përmirësim në sjellje dhe vepra. Kjo rezultoi në krijimin e një kulture dhe qytetërimi aq të lartë dhe madhështor, që

U shfaqën shkollat greke në Greqi, u shfaq lloj-lloj feje hinduse, persiane, kineze dhe egjiptiane, të cilat ndikuan edhe në dy fetë qiellore, në judaizmin dhe në krishterimin,

ndonjëherë e ka njohur njerëzimi.

Mirëpo, ky triumf i shpejtë ushtarak nuk ishte përfundimtar, sepse injorantët hartonin plane për luftë të dytë, por si front kishin zgjedhur ideologjinë, sepse krerët e tyre e kishin kuptuar fuqinë e ndikimit të ideologjisë në sjellje, dhe se lufta ideologjike ishte rruga e vetme në atë kohë për t'i bërë ballë Islamit.

Kjo ishte e mundshme sepse qëndrimet e popujve të cilët pranuan Islamit nuk ishin të njëjta. Disa u gëzuan kur takuan këtë fe dhe e pranuan me gjithë zemër, disa iu përlulën situatës pa e kuptuar fare thelbin e kësaj feje dhe kishte të tjerë që kishin qëndrim armiqësor dhe filluan veprimtari kundër Islamit. Këtë qëndrim të fundit zakonisht e përfaqësonin djemtë e mbretërve, komandantët ushtarakë dhe njerëzit që më parë kishin gëzuar ndonjë autoritet. Ky ishte edhe qëndrimi i "njerëzve të fesë", të

cilëve u humbën postet dhe mirësitë materiale, andaj u mbushën me zemërim dhe tërbim. Tërbimin edhe më tepër ua shtonte fakti se pasuritë e tyre ranë në duar të myslimanëve arabë. Ata nuk dëshironin të pranojnë se "feja" të cilës i besuan një kohë të gjatë, pësoi disfatë.

Muhamed Muhjedin AbdulHamid thotë: "Islamit e pranuan njerëz që i pas-truan zemrat e tyre nga ndyrësitat e imitimit dhe fanatizmit, shpirtat e tyre u hapën për të pranuar thirrjen e të Dërguarit të besimit të drejtë, u qetësuan ndjenjat e tyre kundrejt këtij të Dërguari se është besnik dhe flet vetëm të vërtetën. Andaj, në çdo gjë që i thërreste ata kapeshin fortë për të me dhëmballë dhe kapeshin për këtë lidhje të fortë e cila

Kjo Porosi Hyjnore u dallua me atë se përmbledh çdo gjë që ka nevojë njerëzimi, përfshin secilin njeri, në çdo vend dhe çdo kohë. Ajo bartë njoftimin e drejtë me Allahun dhe me detyrat ndaj Tij, na njofton me gjithësinë, jetën dhe me njeriun, rolin e tij në jetë dhe përfundimin e tij pas vdekjes.

nuk këputet..."

Krahas këtyre, Islamin e pranuan disa lloj njerëzish tjerë:

Lloji i parë - një grup arabësh të cilët hynin në Islam sepse populli i tyre ka vepruar ashtu, pra, hynin në Islam duke imituar shumicën. Këtyre nuk iu largua verbëria edhe pse e panë Pejgamberin paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, nuk iu shërua gjoksi edhe pse dëgjuan mësimet e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, nuk u liruan zemrat e tyre nga gjurmët e injorancës dhe nuk u pastruan nga ato ndyrësira. Për këta njerëz, ishte njësoj nëse triumfoi thirrja Islame apo jo.

Lloji i dytë - grupe njerëzish prej feve të tjera, në veçanti çifutë dhe zjarrputistë, të cilët hynë në Islam gjatë çlirimeve të shumta, kur iu nënshtruan shtetit Islam dy perandoritë e mëdha, greke dhe ajo persiane, me qëllim që t'i shmangen dispozitës Islame për ata që dëshirojnë të mbesin në fenë e tyre³, ndërsa në zemrat e tyre nuk është futur asgjë Islame...

Lloji i tretë - grup njerëzish të këqij - në veçanti çifutë dhe zjarrputistë, të cilët u shtirën se hynë në këtë fe, ndërsa në brendinë e tyre fshihnin kurthet, dredhitë dhe

mashttrimet. Pritnin me padurim momentin për ta sulmuar këtë fe e cila ishte zgjeruar në gjithë tokën, që njihej atëherë. Punonin fshehurazi për të shpejtuar këtë moment dhe i parapërgatitnin ato dy grupe të njerëzve, që i përmendëm, që t'i shoqërojnë në planet e tyre... këta përdornin metoda të ndryshme për t'i përfutur njerëzit, herë duke veshur petkun e namazit, herë të mësimet, herë të dashurisë ndaj Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, dhe familjes së tij...

Lëshonin helmin e tyre duke i shtrembëruar mësimet islame dhe duke futur gjëra që nuk janë pjesë e fesë. Trillonin hadithe për të mbështetur pohimet e tyre dhe kërkonin prej tjerëve (llojit të parë dhe të dytë) që të aktivizohen për ta ndihmuar këtë fe apo për ta ndihmuar familjen e të Dërguarit, i cili e solli këtë fe.

Kjo është ajo për të cilën besoj se është faktori kryesor në ndarjet që kanë ndodhur te myslimanët".⁴

Ziliqarët i shpallën luftë Islamit, prej brenda, luftë e cila kishte për qëllim shkatërrimin e thelbit me të cilin myslimanët triumfuan dhe gjetën krenarinë. Ai thelb është: Besimi i patundur në Allahun dhe respektimi i ligjeve dhe mësimëve fetare.

Kjo luftë nuk bëhej nxitimthi, por në mënyrë të organizuar dhe studiuar. E planifikuar nga çrregulluesit që vinin prej persianëve dhe çifutëve, të cilët mbledheshin dhe konsultoheshin për këtë çështje dhe ngulën këmbë në organizimin e një dredhie që do të ketë ndikim të paparë në përçar-

Mirëpo, ky triumf i shpejtë ushtarak nuk ishte përfundimtar, sepse injorantët hartonin plane për luftë të dytë, por si front kishin zgjedhur ideologjinë, sepse krerët e tyre e kishin kuptuar fuqinë e ndikimit të ideologjisë në sjellje, dhe se lufta ideologjike ishte rruga e vetme në atë kohë për t'i bërë ballë Islamit.

jen e myslimanëve dhe lajthitjen e shumë prej tyre nga rruga e drejtë.

Lajmin e kësaj dredhie e bëri të ditur Ibën Hazmi në librin e tij, "El-Faslu fil mil el uel ehvai uen nihal". Ai ka thënë: "Thelbi për të dalë shumica e këtyre grupeve nga feja Islame është se persianët para Islamit kishin një mbretëri të gjerë dhe një famë të lartë mbi popujt tjerë, saqë vetëm veten dhe djemtë e tyre i quanin të lirë, ndërsa të gjithë njerëzit tjerë janë robër të tyre. Mirëpo, kur u sprovuan me humbjen e shtetit në duar të arabëve, ndërsa më herët, arabët nuk paraqitnin asnjë rrezik në syrin e tyre, kjo gjë iu dukë e madhe dhe fatkeqësia në këtë rast ishte e dyfishtë, andaj u koncentruan në luftimin e Islamit në çdo mënyrë... ata panë se dredhia ishte metoda më e mirë, ashtu që një grup prej tyre hynë në Islam me dyfytirësi dhe duke u shfaqur me dashurinë ndaj familjes së Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, dhe me urrejtjen kundër atyre që sulmuan Alijun, radijallahu anhu, arritën të afrohen me ata besimtarë që anonin nga anëtarët e familjes së Pejgamberit⁵, salallahu alejhi ue selem. Kështu që, arritën t'i përfitojnë tërësisht derisa më vonë t'i nxjerrin nga Islami".

Më pas ka thënë: "Këtë metodë e ka ndjekur edhe çifuti Abdullah b. Sebe el-Humejri, i cili - Allahu e malloftë - shfaqti Islamit për t'i luftuar myslimanët".⁶

"Ibën Hazmi - Allahu e mëshiroftë - na sqaroi se zjarrrputistët ishin tubuar për ta luftuar Islamit dhe myslimanët me dredhi dhe mashtrime, pas bindjes se haptas nuk mund t'i bëjnë

Ziliqarët i shpallën luftë Islamit, prej brenda, luftë e cila kishte për qëllim shkatërrimin e thelbit me të cilin myslimanët triumfuan dhe gjetën krenarinë. Ai thelb është: Besimi i patundur në Allahun dhe respektimi i ligjeve dhe mësimëve fetare.

asgjë. Andaj, shfaqën se e pranuan Islamit dhe me dredhi shfaqën para njerëzve "dashurinë" që kishin ndaj familjes së Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, sepse e dinin se besimtarët e nderojnë me nderim të veçantë atë familje".⁷

Pasi studiuuan gjendjen e myslimanëve, si gjuhë të tyre zgjodhën shiitët e parë. I zgjodhën ata për shkak të dy zbrazëtive që gjendeshin te ata. Ato dy zbrazëti do t'u mundësojnë armiqve që të manipulojnë me ta dhe të mbjellin tek ata çfarëdo mendime shkatërruese që duan.

Zbrazëti e parë: Mospërmbajtja e tyre në rrugën e pasuesve të hadithit, rrugë që ishte ndërtuar mbi marrjen e dijes dhe hadithit, nëpërmjet zinxhirëve të ngjitur nga njerëz të besueshëm. Ndërsa ata, merrnin mendimin që u pëlqente nga kushdo qoftë dhe nga secili që ua ngjallte emocionet kundrejt familjes së ndershme dhe që vajtonte për zullumin që i ndodhi asaj familje, sipas supozimeve të tyre.

Zbrazëti e dytë: Mungesa e matjes së fjalëve të njerëzve në peshoren e shariatit. Tek ata e vërteta njihet me njerëz. Me ata njerëz të cilët janë të kënaqur dhe u pëlqejnë fjalët e tyre - nga ata pranojnë dhe i konsiderojnë argumente të gjalla. Andaj, mashtruesit dhe dredhuesit

Pas ndihmës së Allahut, matja e fjalëve të njerëzve në peshoren e Kur'anit dhe sunetit, kushdo qofshin ata, është faktori kryesor që pasuesit e sunetit të mbesin në rrugë të drejtë dhe të mbrohen nga ideologjitë shkatërruese.

gjetën rrugë fare të lehtë për të manipuluar me ta dhe për t'i mashtruar.

Pas ndihmës së Allahut, matja e fjalëve të njerëzve në peshoren e Kur'anit dhe sunetit, kushdo qofshin ata, është faktori kryesor që pasuesit e sunetit të mbesin në rrugë të drejtë dhe të mbrohen nga ideologjitë shkatërruese.

Është Tejmije, duke përshkruar situatën e këtyre njerëzve, (shiitëve të parë) të cilët u bënë të përshtatshëm për çdo ideologji shkatërruese dhe për çdo qëllim dashakeq dhe duke sqaruar manipulimin e çrregulluesve me ta, ka thënë: "Ata janë njerëz që kur transmetojnë gënjejnë më së shumti dhe kur logikojnë vërehen se janë më të paditurit. Ata besojnë në disa thënie të cilat dihen shumë qartë se janë të kota, ata i përgënjeshtrojnë disa gjëra të qarta dhe të transmetuara me nivelin më të lartë të vërtetësisë, gjatë gjithë gjeneratave. Ata nuk kanë aftësi të dallojnë transmetuesit, nuk bëjnë dallim mes atij që transmeton dijen dhe atij që transmeton përralla. Mbështetja e tyre është në imitim, edhe pse supozojnë se mbështeten në argumente logjike. Ata njerëz, herë pasojnë mu'tezilitë⁸ dhe

Shfaqën se e pranuan Islamin dhe me dredhi shfaqën para njerëzve "dashurinë" që kishin ndaj familjes së Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, sepse e dinin se besimtarët e nderojnë me nderim të veçantë atë familje"

kaderijtë⁹, e herë pasojnë sektet el-muxhessime¹⁰ dhe el-xhibrije¹¹. Këto sekte janë më të paditurit në argumentime dhe të gjithë dijetarët, këta njerëz i numërojnë nga më të paditurit që u futën në mesin e myslimanëve. Disa prej tyre, arritën të bëjnë aso çrregullime në këtë fe (te myslimanët) të cilat i di vetëm Allahu subhanehu ue tealâ.

Të pafetë Ismailij¹² dhe Nusajrij¹³ dhe shumë prej hipokritëve hynë nga dera e tyre dhe shumë prej armiqve tjerë të Islamit erdhën dhe mbisunduan vendet Islame. Robëruan gratë, konfiskuan pasuritë dhe derdhën gjakun e shenjtë.

Nëpërmjet tyre (shiizmit të parë), armiqtë arritën të bëjnë kaos në dynja dhe shtrembërime në fe, në përmasa të tilla që i di vetëm Allahu.

Përktheu: Omer BERISHA

¹ Shih: Hasaisu tasavvuril Islami fq. 22

² Sepse ata besonin se Allahu është Një, Ai jep jetë dhe vdekje dhe Ai sundon me gjithësinë, ndërsa putat i besonin si ndërmjetësues.

³ D.m.th. duke ikur nga tatimi, të cilin duhet ta paguajë jomuslimani që jeton në shtetin Islam.

⁴ Shih: El ferku bejnel firek fq. 4,5.

⁵ Ky ishte shiizmi i parë. Këta dalloheshin vetëm me animin e tyre kah familja e Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, por nga padija e tyre, do të shohësh në vijim se si u zhvillua situata.

⁶ Shih: El-Faslu fil mileli uel ehvai uen nihali 2/273-274

⁷ Shih: Kitabul Imame uer-reddu aler-rafida, fq. 14

⁸ Mu'tezilij quhen pasuesit e Vasil b. Ata, i cili shpiku mendimin se kush bën mëkatë të mëdha është mes dy vendeve (as në xhenet as në xhehenem). Si pasojë e këtij mendimi u përjashtua nga hallka e dijes që udhëhiqte dijetari Hasan Basriu dhe u quajtën mu'tezilij (të larguar, të përjashtuar). Këta po ashtu mohojnë cilësitë e Allahut dhe caktimin e Tij.

⁹ Kaderij janë ata që mohuan kaderin (caktimin) e

Allahut të Gjithdijshëm.

¹⁰ Muxhessime quhen ata që thanë se Allahu është një lloj trupi, me gjatësi, gjerësi, brendësi, erë dhe çdo cilësi trupore që njohin njerëzit.

¹¹ Xhibrije quhen ata që thonë se krijesat nuk kanë të drejtë zgjidhjeje, janë të detyruar paraprakisht të vepronë veprat e tyre dhe nuk kanë asnjë liri në to.

¹² Ismailij janë pasuesit e njëfarë Muhamed b. Ismail. Këta shenjtërojnë imamët e tyre, supozojnë se çdo shtyllë e sheriatit ka kuptim të fshehtë, p.sh. namazi ka kuptimin e respektit ndaj imamit, haxhi ka kuptimin e vizitës së imamit, thonë se kjo botë është e përhershme si dhe shumë fëlliqësi tjera.

¹³ Nusajrije quhen pasuesit e Muhamed b. Nasër en-Nusajri. Ky njeri fillimisht pretendoi se është pejgamber e pastaj edhe zot. Pasuesit e tij besojnë se Allahu u mishërua në Alijun, radijallahu anhu. Ata i lejojnë të gjitha haramet dhe kanë shumë besime tjera të kota. Është Tejmije për ata ka thënë se janë edhe më kafira se jehudit, krishterët, madje edhe më kafira se shumë prej idhujtarëve.

Dispozita të nevojshme rreth leximit të Kuranit

shkruajnë: **Fadil MUSLIU, Alaudin ABAZI**

Ëurani është Libri i fundit, që Allahu i Lartësuar ia zbriti njerëzimit, prandaj urtësia e të Lartësuarit ishte që mësimet, dispozitat dhe informatat, me një fjalë, e gjithë përmbajtja e tij, të jetë e vlefshme prej momentit që i është shpallë Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, e derisa të ekzistoj kjo botë. Pikërisht, kjo është edhe mrekullia më e madhe e këtij libri të shenjtë.

Por ajo që e bën edhe më të veçantë këtë libër, kundrejt librave të tjerë, është edhe fakti se leximi i tij konsiderohet adhurim (ibadet) shumë i vlefshëm për besimtarin, madje nga besimtari kërkohet të mësojë përmendësh disa pjesë nga Kurani në origjinal.

Ebu Umame, radijallahu anhu, lidhur me vlerën e leximit të Kuranit dhe shpërblimin që e arrin myslimani, transmeton se ka dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: "Lexojeni Kur'anin, vërtet ai do të ndërmyjetësojë Ditën e

Gjykimit për të zotët e vet".¹

Gjithashtu, Ebu Musa El-Esh'ariu, radijallahu anhu, thotë se Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Shembulli i besimtarit që lexon Kur'anin, është sikurse shembulli i qitros; aroma e së cilës është e mirë dhe shijen e ka të mirë dhe shembulli i besimtarit që nuk e lexon Kur'anin, është sikurse hurma; nuk ka erë, por shijen e ka të ëmbël...".²

Janë të shumta thëniet që vërtetojnë se leximi i Kuranit konsiderohet adhurim, madje kjo llogaritet edhe si një nga adhurimet e përditshme të besimtarit. Prandaj edhe është e nevojshme të sqarohen disa dispozita që kanë të bëjnë me leximin e tij, kështu që besimtari të ketë mundësi ta kryej këtë adhurim në formën më të mirë dhe konform normave të cilat janë të sqaruara në Islam përkritazi me këtë.

1. Leximi i Kuranit pa abdes

Fukahatë janë në ujdj (ixhma) se është i lejuar leximi i Kuranit përmendësh pa abdes, por abdesi në këtë

rast është i preferuar (mustehab).³

Imam Neveviu, në një libër që flet rreth normave të leximit të Kuranit, të quajtur "Et-Tibjan fi adabi hameletil Kuran" thotë: "Preferohet që Kurani të lexohet me abdes, por edhe nëse lexohet pa abdes është e lejuar dhe këtë mendim e ndajnë të gjithë ulematë".

Po ashtu, ai në një libër tjetër të tij "El mexhmu", thotë: "Të gjithë mys-

Nga kjo ngjarje shohim argumentin e qartë se është i lejuar leximi i Kuranit në vete (përmendësh) edhe pa abdes. Prandaj nga këto argumente që u përmendën konstatojmë se është i lejuar leximi i Kuranit përmendësh edhe pa abdes dhe për këtë argumentet janë të qarta dhe bindëse.

limanët janë të mendimit se lejohet leximi i Kuranit pa abdes, mirëpo më mirë është që të marrim abdes për këtë". Nga këto citate të lartpërmendura vërejmë se dijetarët në këtë kanë Ixhma (konsensus).

Argumentet që aludojnë në lejimin e leximit të Kuranit pa abdes janë të shumta, kurse ne do t'i përmendim disa:

Së pari: Argumente nga suneti i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem:

1. Transmeton Kurejbi, robi i Ibën Abasit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se atij i ka treguar Ibën Abasi se me një rast ai kishte bujtur te tezja e tij Mejmuneja (e cila ishte grua e Muhamedit, salallahu alejhi ve selem. Ai kishte rënë të flejë në një jastëk me Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem.

Ibën Abasi tregon se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, kishte fjetur deri nga mesi i natës, pastaj ishte zgjuar dhe me duart e tij filloi ta largoj gjumin nga fytyra. Pastaj ai lexoi dhjetë ajetet e fundit të sures Alu Imran, u ngrit, mori abdes në mënyrën më të mirë dhe filloi të falet. Ibën Abasi thekson se edhe ai veproi ashtu si kishte vepruar Muhamedi, salallahu alejhi ve selem.⁴

Në këtë hadith vërejmë se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem ka lexuar dhjetë ajetet e fundit të sures Alu Imran pasi është zgjuar nga gjumi dhe pastaj ka marrë abdes për namaz, dhe nga kjo argumentohet se leximi i Kuranit përmendësh edhe pa abdes është i lejuar.

2. Aishja, radiallahu anha, thotë: "Pejgamberi salallahu alejhi ve selem përmendte Allahun në çdo kohë".⁵

Edhe nga ky hadith shohim se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem e ka përmendur (kujtuar) Allahun në çdo kohë, që do të thotë se ky hadith është i përgjithshëm dhe në këtë hyn edhe leximi i Kur'anit sepse Kur'ani është dhikri (përmendja) më i mirë dhe preferohet të bëhet në çdo gjendje përveç rasteve kur është ndaluar leximi i Kur'anit si rasti kur njeriu është xhunub. Pra edhe ky është një argument se lejohet leximi i Kuranit në vete edhe pa abdes.

3. Abdullah bin Seleme thotë: "Kur kemi hyrë te Aliu, radiallahu anhu,

unë dhe dy burra prej fisit tonë dhe një burrë prej fisit Beni Esed, Aliu radiallahu anhu ktheu kokën dhe na tha: "Ju dy jeni të fortë prandaj forconi fenë tuaj". Më pas ai hyri në një kthinë të dhomës mori një enë me ujë, i futi duart në të dhe i lau, pastaj filloi të lexoj Kuran. Ne nuk u pajtuam me Aliun, radiallahu anhu, në këtë (se lexoi Kuran pa marrë abdes) e ai tha: "I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem kur ka dal nga tualeti, ka lexuar Kuran, ka ngrënë me ne mish dhe asgjë nuk e ka penguar nga leximi i Kuranit përveç xhunubllëkut".⁶

Për t'ia ndaluar gruas me menstruacione leximin e Kuranit, duhet të posedojmë argument, me të cilin e ndërtojmë dispozitën e ndalimit (tahrir). Por, kjo nuk është bërë dhe argumentet të cilat janë sjelë nuk janë të qëndrueshme, prandaj mbetet dispozita e përgjithshme, se ajo është e lejuar.

Së dyti: Argumente nga praktika e sahabëve:

Transmeton Ebu Garif El-Hamdhani: "Ishim me Aliun radiallahu anhu në Ruhbe (fshat gjatë rrugës prej Kufes për në Mekë), ai shkoi në fund të këtij

fshati dhe për Zotin nuk e di nëse ka kryer nevojën e vogël apo të madhen, pastaj mori një enë me ujë i lau duart e tij dhe lexoi një pjesë të Kuranit dhe tha: "Lexoni Kuran përderisa nuk jeni xhunub e kur të jeni xhunub mos lexoni as një shkronjë të vetme".⁷

Nga kjo ngjarje shohim argumentin e qartë se është i lejuar leximi i Kuranit në vete (përmendësh) edhe pa abdes. Prandaj nga këto argumente që u përmendën konstatojmë se është i lejuar leximi i Kuranit përmendësh edhe pa abdes dhe për këtë argumentet janë të qarta dhe bindëse.

Në fund të kësaj dëshirojmë të

theksojmë edhe atë se nëse thuhet se leximi i Kuranit pa abdes është i lejuar, kjo nuk nënkupton që të bëjmë shprehje ta praktikojmë këtë gjithmonë pa abdes, pasi që Muhamedi salallahu alejhi ve selem edhe pse vërtetohet se ka lexuar Kuran pa abdes, gjithashtu, vërtetohet në shumë hadithe tjera se ai ka urryer përmendjen e Allahut pa marrë abdes, madje tregohet se ai ka urryer ta kthejë edhe selamin pa qenë me abdes.

2. Leximi i Kuranit për atë që është me Istihada.

Istihada quhet gjendja kur gruaja ka hemorragji (gjakderdhje nga organi seksual) jashtë kohës së menstruacioneve. Istihada në vete përmban dispozita të ndryshme, por ajo që do të trajtohet në këtë rast është se a i lejohet apo jo të lexojë Kuran gruas që është në këtë gjendje (pra që ka gjakderdhje jashtë kohës së menstruacioneve).

Katër medh'hebet janë në ujdj se lejohet leximi i Kuranit për atë që është me gjakderdhje pas kohës së menstruacioneve (istihada).

Pra, mendimi se gruas që është me istihada i lejohet të lexojë Kuran është mendimi i dijetarëve të medh-hebit Hanefi, Maliki, Shafi dhe Hanbeli.

Ibni Hani në librin "Mesail el-Imam Ahmed" thotë: "Është pyetur Imam Ahmedi për atë që është me istihada a bën të shikoj në Kuran dhe

të lexoj ai tha: "Po, sepse ajo kur është me istihada falë namazin dhe agjëron".

Po ashtu, të këtij mendimi janë edhe Dhahiritë (si Ibën Hazmi dhe të tjerët), madje ata thonë se i lejohet edhe femrës me menstruacione të lexojë Kuran, andaj, ajo që është me istihada ka përparësi në lexim sepse gjaku i menstruacioneve është më i papastër se gjaku i Istihadës.

Argumentet se gruas me istihada i lejohet të lexojë Kuran janë:

Së pari: Argumente nga suneti.

Aishja radiallahu anha thotë se Fatime bint ebu Hubejsh i ka thënë Pejgamberit salallahu alejhi ve selem: "O i dërguari i Allahut unë nuk po pastrohem (d.m.th. edhe pas menstruacioneve po më vazhdon gjakderdhja) a ta lë namazin?"

Janë të shumta thëniet që vërtetojnë se leximi i Kuranit konsiderohet adhurim, madje kjo llogaritet edhe si një nga adhurimet e përditshme të besimtarit.

Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i tha asaj: "Ajo është gjak i cili rrjedh nga damarët dhe nuk është gjak i menstruacioneve, kur të vinë menstruacionet leje namazin dhe kur të kalojnë ato pastrohu (merr gusël) dhe falu".⁸

Me këtë hadith argumentojmë se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, urdhëroi Fatime bint Ebi Hubejsh (e cila ishte me istihada) që të pastrohet kur të kalon koha e menstruacioneve dhe të falet, andaj këtu hynë edhe leximi i Kuranit dhe ky është argument i fortë i cili lejon leximin e Kuranit për ato gra që janë me istihada.

Së dyti: Argumente nga logjika e shëndoshë.

Logjikisht: Istihada është ndyrësirë e pazakonshme që i përngjanë gjakderdhjes së përgjithshme, sikurse kullimi i varrës (tek i sëmuri ose i plagosuri), pastaj ai i cili nuk arrin ta mbajë urinën, etj. Prandaj është i lejuar leximi i Kuranit për atë që është në këtë gjendje (istihada), sikurse për atë që vuan nga hemorragjia dhe pamundësia e mbajtjes së urinës.

Me këtë na bëhet e qartë kompaktësia e dijetarëve për istihaden dhe dispozitën e saj se ajo që është në këtë gjendje konsiderohet e pastër dhe i lejohet leximi i Kuranit. Allahu e di më së miri!

3. Leximi i Kuranit nga gruaja lehonë dhe me menstruacione.

Në këtë ka mospajtim të fukahat⁹ islamë, prandaj për të qenë më lehtë kuptimi i çështjes, me poshtë do të flasim rreth saj në disa pika, duke filluar nga gjërat me të cilat fukahatë janë pajtuar, e pastaj do të kalojmë në shtjellimin e vendit të mospajtimit.

Së pari: Thënia e duave (lutjeve) të Profetit (bekimi dhe paqja qofshin mbi të), sikurse lutjet e mëngjesit e të mbrëmjes, duaja e hyrjes në shtëpi, daljes nga ajo dhe lujet tjera të rëndësishme të cilat bëhen gjatë situatave të ndryshme, të gjitha këto janë të lejuara të thuhet dhe në të nuk ka ndalesë. Madje, preferohet nga gruaja me menstruacione të vazhdojë me thënien e lutjeve të këtilla

Së dyti: Lutjet siç janë:

1. "BISMILAHİ RRAHMANİ RAHİM" - "Në emër të Allahut Mëshiruesit Mëshirëplotit".

2. "Ina lil-lahi ve ina ilejhi raxhiun" - "Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!" Bekare, 156.

3. "Rabena atina fi dunja haseneten ve fil ahireti hasenete ve kina adhabenar" - "Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!" Bekare, 201.

Dhe lutjet e ngjashme të cilat gjenden në Kuran dhe janë ajete të plota ose pjesë të ajeteve, por ato përdorën si lutje, atëherë edhe këto janë të lejuara që t'i thotë femra lehonë dhe me menstruacione.

Së treti: Leximi i Kuranit për femrën me menstruacione me qëllim të adhurimit, d.m.th që ajo gjatë këtyre ditëve të ulët dhe të lexojë Kuran si adhurim, ose të përsërisë pjesët të cilat më herët i ka mësuar përmendësh është diskutabile të dijetarët islam.

Mendimi i parë: Pjesa dërmuese e ulemave (hanefitë, shafitë dhe hanbelitë) janë të mendimit se kjo është e ndaluar dhe se gruaja gjatë këtyre ditëve duhet të largohet nga leximi i Kuranit, deri sa të pastrohet.

Për këtë qëndrim kanë argumentuar me këto argumente:

1. Gruaja e cila është me menstruacion është e papastër dhe kjo është sikurse myslimani i cili bëhet xhunub (pas marrëdhënies intime), pasi që

në të dy rastet është obligativ gushi (larja e trupit).

Ali b. Ebi Talibi tregon se i dërguari, salallahu alejhi ue selem ua mësonte Kuranin atyre (gjithmonë) dhe nuk e ndante atë asgjë nga Kurani përveç xhunublëkut"¹⁰.

2. Transmetohet nga Abdullah b. Umeri se i dërguari, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: "Ajo që është me menstruacione dhe xhunub mos të lexojë asnjë pjesë nga Kurani".¹¹ [2]

Mendimi i dytë:

Një pjesë më e vogël e dijetarëve (medh'hebi i imam Malikut) lejojnë që femra me menstruacione të këndojë Kuran. Ky mendim thuhet se është edhe thënie e imam Ahmedit, por ajo që është më e vërtetuar nga ai është qëndrimi i parë, i moslejimit.

Sido që të jetë, qëndrimi i dytë është zgjedhur nga një numër i fukahave, qofshin më të hershëm ose të cilët kanë ardhur më pas, si Ibën Tejmije, Sheukani dhe me këtë mendim japin fetva shumë nga dijetarët bashkëkohorë. Kurse argumentet e tyre janë:

1. Argumentimi për t'ia ndaluar gruas me menstruacione leximin e Kuranit duke bërë analogji (kijas) me xhunubin është krahasim ndërmjet dy çështjeve që nuk janë të njëjta, pasi që njeriu xhunub ka mundësi në çdo moment të pastrohet, kurse gruaja me menstruacione nuk ka mundësi ta bëjë këtë, madje ajo është e mundur të

qëndroj një kohë të gjatë (prej tri deri në dhjetë ditë) në atë gjendje. Pastaj njeriu xhunub, qoftë burrë ose grua, është i obliguar të pastrohet (merr gusul) në momentin kur hynë koha e namazit, për ta falur atë, kurse femra me menstruacione është e obliguar të pastrohet kur të kryhet koha e menstruacioneve. Prandaj ky kijas nuk është i saktë.

2. Argumentimi me hadithin e lartëpërmendur (Ibën Umerit) nuk është i qëndrueshëm, pasi që është i dobët dhe nuk mund të argumentohet me të për të ndaluar këtë çështje.

3. Esenca nga e cila duhet të nisemi në këtë çështje është se për t'ia ndaluar gruas me menstruacione leximin e Kuranit, duhet të posedojmë argument, me të cilin e ndërtojmë dispozitën e ndalimit (tahrin). Por, kjo nuk është bërë dhe argumentet të cilat janë sjellë nuk janë të qëndrueshme, prandaj mbetet dispozita e përgjithshme, se ajo është e lejuar.

Ibën Tejmije thotë: "Nuk posedojmë argumente të qarta dhe të sakta për t'ia ndaluar leximin e Kuranit gruas me menstruacione". Ai, gjithashtu, thotë: "Është e njohur se grave në kohën e Profetit (bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të) u vinin menstruacione dhe nuk tregohet se ai ua ndalonte atyre leximin e Kuranit, ashtu siç nuk ua ndalonte dhikrin dhe lutjet".

4. Gjatë kohës së menstruacioneve femra mund të ndeshet në disa situata

Nëse thuhet se asaj i lejohet të lexoj Kuran nuk do të thotë se asaj i lejohet edhe prekja e Kuranit me dorë gjatë menstruacioneve. Prandaj këto dy gjëra janë të ndara. Prekja me dorë e Mus'hafit (Kuranit) për gruan me menstruacione është e ndaluar.

ku duhet të mësoj Kuranin, ta përsërisë atë (posaçërisht nëse mëson në medrese ose fakultete Islame) për shkak të provimeve, ose edhe në disa raste specifike si rasti i sëmundjes, frikës, rukjes së vetës (fryrjes së vetës me Kuran), etj. Prandaj nëse asaj i`a ndalojmë këtë, atëherë e kemi ndaluar nga një gjë që është mjaft e rëndësishme për të dhe e kemi privuar nga shumë dobi për të cilat ajo ka nevojë.

- Nga ajo që u tha më lartë vërejtëm fuqinë e argumenteve të atyre që thonë se gruas me menstruacione i lejohet të lexojë Kuran, por nëse ajo dëshiron të jetë më e kujdesshme dhe më e matur në këtë, atëherë do të ishte më mirë për të, që ta lexojë Kuranin në këtë kohë (gjatë menstruacioneve) vetëm atëherë kur është e domosdoshme për të dhe kur ajo ka nevojë për të lexuar ashtu siç cekëm në disa raste të lartëpërmendura.

Vërejtje: Ajo që do të ishte e nevojshme të përmendet në këtë vend është çështja e prekjes së Kuranit me dorë nga femra me menstruacione. Për shkak se nëse thuhet se asaj i lejohet të lexoj Kuran nuk do të thotë se asaj i lejohet edhe prekja e Kuranit me

dorë gjatë menstruacioneve. Prandaj këto dy gjëra janë të ndara. Prekja me dorë e Mus`hafit (Kuranit) për gruan me menstruacione është e ndaluar. Dhe për këtë argumentojmë me ajetin e përgjithshëm ku Allahu i Lartësuar thotë: "Atë (Kuranin) nuk e prekin, vetëm se të pastrit". Vakia, 79.

Për këtë, kur themi se lejohet leximi, është për qëllim leximi përmendësh, përsëritja ose dëgjimi nga dikush që lexon. Kurse nëse ajo duhet ta përdorë Kuranin gjatë përsëritjes, atëherë duhet të ketë kujdes mos ta prekë drejtpërdrejt me dorë, por të vej dorëza dhe ta shfletoj me dorëza, ose ta shfletojë atë me diçka tjetër.

Kurse nëse ajo lexon ndonjë libër që përmban ajete të Kuranit, ose Kuranin me përkthim ose Kuranin me komentim, atëherë lejohet ta prekë atë, pasi që Kurani i cili është i ndaluar të preket nga gruaja me menstruacione është Mus`hafi ku gjendet e përmbledhur vetëm fjala e Allahut dhe jo librat tjera ku kemi edhe shkrime tjera. Allahu e di më së miri!

(Vazhdon)

¹ Shënon Muslimi.

² Shënon Buhariu dhe Muslimi.

³ Duhet ta kemi parasysh se këtu është fjala për leximin arabisht.

⁴ Shënon Buhariu dhe Muslimi

⁵ Buhariu dhe Muslimi

⁶ Shënon Tirmidhiu, Ebu Davudi, Ibni Maxhe, Bejhekiu, Nesaiu, Darukutniu dhe Ahmedi.

⁷ Shënon Darukutni, Bejhekiu dhe Abdurrezaku.

⁸ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

⁹ Fukaha është shumësi i fjalës fekih që d.m.th. dijetar i jurisprudencës islame

¹⁰ Shënon Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu, Ahmedi, Tirmidhiu e cilëson hadithin si hasen sahih, ndërsa Ibën Haxheri thotë se hadithi është Hasen dhe mund të argumentohet me të.

¹¹ Shënon Tirmidhiu, Ibën Maxhe, Darekutniu dhe Bejhakiu. Hadithi është i cilësuar i dobët, ashtu si shtjellohet nga Zejleiu në "Nasbu Rraje" dhe Ibën Haxheri në "Telhisu Habir". Kurse Ibën Tejmeje thotë se hadithi është i dobët me pajtimin e dijetarëve të hadithit.

Mos i shndërroni shtëpitë në varreza!

shkruan: Omer ZAIMI

Falënderimi dhe lavdërimi i plotë i takon Allahut, për të gjitha të mirat që na i ka dhënë, në krye të cilave është feja islame.

Abdullah b. Revaha radijallahu anhu ka thënë: Po të mos të ishte Allahu nuk do të udhëzoheshim dhe nuk do të agjëronim e nuk do të faleshim.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij fisnik, mbi familjen e tij të ndershme, mbi shokët e tij të pastër dhe të sinqertë dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Ebu Hurejra radijallahu anhu rrëfen se Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varreza, mos e shndërroni varrin tim në festë, dhe dërgoni salavate mbi mua, sepse me të vërtetë salavatet tuaja më arrijnë mua, prej kudo qofshin".¹

Ky hadith - edhe pse ka pak fjalë -

përmban kuptime të mëdha dhe dispozita të rëndësishme fetare. Në shikim të parë duket se ka të bëjë vetëm me dispozita të fikhut, por e vërteta është se ka të bëjë me çështje shumë të rëndësishme të besimit, siç do ta sqarojmë, duke mos mohuar edhe çështjet e fikhut.

Para se të futemi në thelbin e temës, do të doja t'i përmendi dy gjëra shumë të rëndësishme:

E para: Esenca e shirkut (idhujtarisë) është teprimi në hakun e njerëzve të mirë. Kjo manifestohet në shumë mënyra, e disa prej tyre janë: përsëkrimi i tyre me disa cilësi që i takojnë vetëm Allahut, adhurimi i tyre duke u drejtuar lutje dhe duke therur kur-

ban te varret e tyre, zbukurimi dhe ngritja e tyrbeve mbi varret e tyre dhe adhurimi i tyre, gjë që padyshim është shirk, sepse askush, përpos Allahut, nuk meriton të adhurohet.

Allahu i Madhërisëm ka thënë: "...dhe

"Mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varreza, mos e shndërroni varrin tim në festë, dhe dërgoni salavate mbi mua, sepse me të vërtetë salavatet tuaja më arrijnë mua, prej kudo qofshin".

mos lut askënd tjetër përveç Allahut." (Xhinn 18).

Ndërsa Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Duaja është adhurim".²

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, i ka mbyllur të gjitha rrugët që dërgojnë deri në shirk dhe transmetohen hadithe të shumta në këtë drejtim, prej tyre edhe hadithi për të cilin po flasim.

E dyta: Njerëzit - lidhur me pozicionimin e tyre ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të - ndahen në tri grupe:

a) Ata që nuk besuan në të, nuk ia dhanë hakun që i takon dhe nuk e pasuan, madje ndoshta edhe e ofenduan dhe luftuan. Kjo është gjendja e jobesimtarëve.

b) Ata që ranë në ekstremin e kundërt, duke ia përshkruar atij disa cilësi të Allahut dhe duke e adhuruar atë. Ndërsa ata që kanë shpëtuar nga kjo, kanë shpikur lloj-lloj bidatesh, të cilat nuk i ka


vepruar ai.

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Kush shpikë në fenë tonë diçka që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar."³ Po ashtu ka thënë: "Kush vepron një vepër të shpikur, ajo është e refuzuar".⁴

c) Ata që Allahu i udhëzoi në rrugën e drejtë. Ata i besuan të Dërguarit të Allahut dhe shpalljes që iu shpallë, mirëpo nuk i mveshën cilësi që i takojnë vetëm Allahut dhe nuk e adhuruan, sepse askush, përveç Allahut, nuk meriton të adhurohet. Siç ka thënë Allahu: "Dhe të është shpallur ty dhe atyre që ishin para teje se nëse bën shirk, do të asgjësohen veprat tuaja dhe do të jesh prej të dështuarve" (Zumer 65). Po ashtu, ka thënë: "Allahu nuk e fal shirkun, dhe ia fal pos kësaj atij që dëshiron" (Nisa 48).

Ata pasuan sunnetin e tij dhe nuk shpikën gjëra në fe të cilat ai s'i ka vepruar. Janë ata që ia dhanë hakun fjalës - La ilahe il-Iallah Muhammedun Resulull-llah, duke mos

"Shembulli i shtëpisë në të cilën përmendet emri i Allahut dhe shtëpisë në të cilën nuk përmendet emri i Allahut është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit"



Allahu i Madhërishëm thotë: "Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij dërgojnë salavate mbi të dërguarin. O ju që keni besuar dërgoni salavate mbi të dhe përshëndeteni me selam".

adhuruar askënd tjetër përveç Allahut dhe duke e besuar Muhamedin, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, si të Dërguar të fundit, pas të cilit nuk ka Pejgamber. Duke pasuar sunnetin e tij dhe duke mos shpikur bidate në fe.

Tani futemi në thelbin e temës dhe duke kërkuar ndihmë nga Allahu themi:

1- "Mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varreza..."

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, në këtë pjesë të hadithit, na ndalon nga përngjasimi i shtëpive tona me varrezat, nëse nuk falim namaz (nafile) në to.

Muslimi transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Shembulli i shtëpisë në të cilën përmendet emri i Allahut dhe shtëpisë në të cilën nuk përmendet emri i Allahut është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit".⁵

Muslimi, po ashtu, shënon se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Namazi më i vlefshëm për një mashkull është në shtëpinë e tij përveç farzeve".⁶

Ndërsa sa i përket femrës ka thënë: "Mos i ndaloni gratë tuaja nga shkuarja në xhami, mirëpo më mirë për to janë shtëpitë e tyre".⁷

E ka ngjasuar këtë gjë me varrezat sepse në to nuk lejohet namazi, e as në drejtim të tyre. Siç shënon Muslimi, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Mos u falni në drejtim të varreve dhe mos u ulni mbi to".⁸

Po ashtu, disa orë para vdekjes së tij, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të,

ka thënë: "Allahu i mallkoftë çifutët dhe të krishterët. I morën varret e pejgamberëve të tyre si vendfalje".⁹

Nga kjo pjesë e hadithit nxjerrim disa dispozita:

- Ndalim të përngjasimit të shtëpive me varreza, duke mos falur namaz në to.

- Ndalim të namazit në varreza.

- Ndalim të namazit në drejtim të varreve.

- Ndalim të uljes mbi varre.

- Ndalim të ndërtimit të xhamive mbi varre.

- Ndalim të ndërtimit të varreve në xhamia.

2 - "...mos e shndërroni varrin tim në festë (iid)..."

Fjala arabe "iid" rrjedhë nga folja "adejeudu" që d.m.th: diçka që kthehet dhe përsëritet. Pra, festa mbahet në një kohë të caktuar dhe përsëritet çdo vit, muaj apo javë. Festa bëhet për të kremtuar me rastin e ndonjë ndodhie të caktuar.

Andaj, dije - Allahu të mëshiroftë - se festat janë pjesë e fesë, kurse feja islame ka vetëm tri festa: festën e Fitër-Bajramit, festa e Kurban-Bajramit dhe festa javore që është dita e xhumasë, siç transmeton Ibën Huzejme.¹⁰

Çdo festë jashtë këtyre është bidat dhe nuk lejohet të festohet, qoftë dita e të dashuruarve, 8 marsi, 7 marsi, 1 maji, etj...

Pra, i Dërguari i Allahut na ndalon që ta caktojmë një kohë të caktuar për vizitën e varrit të tij. Nëse kjo është kështu për njeriun më të mirë, atëherë vlen për të gjithë njerëzit tjerë.

Ndalohet ajo që e bëjnë disa njerëz duke festuar ditëlindjen e filan "evlijasë" te varri i tij. Nuk lejohet të caktohet një ditë për vizitën e varrezave, nuk lejohet festimi i ditëlindjes së Pejgamberit paqja

dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, te varri i tij apo diku tjetër, apo festimi i ditëlindjes së dikujt tjetër.

Ditëlindja (mevludi) nuk është festë prej festave islame, dhe sikur të ishte diçka e mirë, i pari që do ta praktikonte do të ishte Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, si dhe shokët e tij. Apo mos vallë dëshirojnë t'ia tregojnë fenë të Dërguarit të Allahut, duke bërë vepra që ai nuk i ka bërë?!

Pra, lexues i nderuar, nga kjo që thamë t'u bë e qartë se nuk lejohet caktimi i vizitës së varrezave pas namazit të Bajramit, siç veprojnë të paditurit në mesin tonë, si dhe ata që e dinë të vërtetën, por e fshehin atë.

Nga kjo pjesë e hadithit i nxjerrim këto dispozita:

- Ndalim i caktimit të një kohe për vizitën e varrezave, por i viziton sipas mundësi, pa e caktuar dhe shndërruar atë në festë.

- Ndalim i festimit të ditëlindjes (mevludit) së kujtdo qoftë.

- Ndalim i festimit të çdo feste jashtë festave islame.

- Ndalimi i caktimit të vizitës së varrezave pas namazit të Bajramit.

3 - "... dhe dërgoni salavate mbi mua..."

Allahu i Madhërishëm thotë: "Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij dërgojnë salavate mbi të dërguarin. O ju që keni besuar dërgoni salavate mbi të dhe përshëndeteni me selam". [Ahzab: 56].

Ndërsa Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Kush dërgon salavate mbi mua një herë, Allahu do të dërgojë mbi të dhjetë herë".¹¹

Po ashtu, thotë: "Është koprrac ai që përmendem në prezencë të tij dhe nuk dërgon salavate mbi mua"¹².

4 - "...sepse me të vërtetë salavatet tuaja me arrijnë mua, prej kudo qofshin"

Pra, siç ceket në një transmetim tjetër¹³, kudo që të jemi mund të dërgojmë salavate mbi të Dërguarin e Allahut, sepse ato i mbërrijnë, meqë ia dërgojnë melekët (engjëjt).

Pra, s'ka nevojë t'i themi atij që shkon në Medinë: "Bëni selam Resulullahit prej meje", sepse selami i arrin atij prej çdo vendi ku jemi.

Allahumme sal-li ala nebijjina Muhammed ve ala alihi ve sahbihi exh-mein.

¹ Hasen, e shënon Ebu Davudi Nr. 2042

² Shënon Tirmidhiu nr. 2969, Ibën Maxhe nr. 3828, Ahmedi nr. 18542. të gjithë nga N'uman b. Beshiri. Për senedin e të cilit Tirmidhiu thotë "Hasen-Sahih". Ndërsa shejh Albani e konsideron të sakt në dy librat e parë të lartpërmendur

³ Shënon Buhariu, nr. 2697 dhe Muslimi, nr. 1718 të dy nga Aisheja, radijAllahu anha

⁴ Shënon Muslimi, nr. 1718 nga Aisheja, radijAllahu anha

⁵ Muslimi nr. 779 nga Ebu Musa Esh'ariu. Po ashtu me kuptim të përafërt e shënon edhe Buhariu nr.6407 nga I njejt i sahabi

⁶ Shënon Buhariu nr. 731... dhe Muslimi nr. 781. të dy nga Zejd b. Thaabiti

⁷ Shënon Ebu Davudi nr. 567. Senedin e të cilit e saktëson shejh Albani. Gjithashtu me tekst të përafërt e shënon Buhariu nr. 900 dhe Muslimi nr. 442 që të gjithë nga Abdullah b. Omeri

⁸ Shënon Muslimi nr. 972 dhe Nesaiu nr. 760. Nga Ebu Merthed Ganeviu

⁹ Transmeton Muslimi nr. 529. Po ashtu me fjalë të përafërta e transmeton Buhariu nr. 4441, të dy nga Aisheja, radijAllahu anha

¹⁰ Në Sahihun e tij nr. 1465 nga Abullah b. Zubejri.

¹¹ Shënon Muslimi nr. 408, Ebu Davudi nr. 1530, Tirmidhiu nr. 485, Nesaiu nr 1396 të gjithë nga Ebu Hurejre

¹² Transmeton Tirmidhiu nr. 3546, dhe Ahmedi nr. 1735. nga Ali b. Ebi Talib. Sendin e të cilit e saktëson Albani

¹³ Të cilin e shënon Nesaiu nr. 1282 nga Abdullah b. Mes'udi, senedin e të cilit e saktëson Albani

Dilemat e studenteve mes martesës dhe përfundimit të studimeve

43

Dr. Lejla JEBUMI

Vallë një vajzë duhet t'i japë përparësi studimeve shkencore apo martesës? A të zgjedhë të jetë grua dhe nënë apo ta mbarojë magistraturën e doktoratën? ... dhe vallë vajza e sotme dallon nga vajzat e së kaluarës në këndvështrimin e saj ndaj jetës, martesës, familjes dhe mëmësisë?

Opinionet:

- Muna Salih, thotë: Gjersa isha duke studiuar në Fakultetin e inxhinierisë mu ofruan shumë djem për martesë dhe nuk ishin të përshtatshëm për mua apo thënë më mirë isha duke e pritur atë më të mirin. Kur mbarova studimet në degën e komunikacionit - Fakulteti i inxhinierisë, gjithashtu nuk mu ofrua djaloshi i përshtatshëm, kështu që fillova të punoj në një punë të mirë dhe me këtë u vështirësua edhe më shumë çështja ngase, specifikat e kërkuara për burrin e përshtatshëm u bënë edhe më të vështira. Unë tashmë i kam kaluar të 27-at dhe nuk jam martuar ende por, ende jam e vendosur në qëndrimin tim dhe nuk do të lëshoj pe.

- Mi Ruzhdi, absolvent e Fakultetit të Farmacisë, thotë: Nëna ime është mjeke dhe ishte fejuar me babin tim gjatë



studimeve ngase, gjyshja ime e ka edukuar asisoj dhe çështja më e rëndësishme në këtë familje është martesë e femrave e unë jam ndikuar pa e ndjerë me këtë mendim. Kur mu ofrua një djalë që ka mbaruar Fakultetin e gazetarisë, punon në administratën e përgjithshme të një firme dhe gjendja e tij financiare është e mirë, familja ime u pajtua dhe do ta kemi martesën menjëherë pas përfundimit të studimeve.

E refuzon detyrimin:

Emine Muhamed, e ka kryer Fakultetin e Arteve të Bukura - dega e Arkitekturës, është në përgatitje e sipër të temës së magistraturës dhe punon në një firmë, thotë: Jam lodhur shumë derisa kam gjetur këtë punë dhe falën-

Gruaja dhe familja

deroj Allahun që i vazhdoj studimet gjithashtu. Më është ofruar një djalë për martesë. Ai është mjek dhe ishte i lumtur që unë punoja por, kjo në fillim. Gjatë takimeve të para më fliste për aspiratat shkencore dhe për hollësitë e punës time por, kur filluam t'i bëjmë procedurat e fejesës kërkoi nga unë që ta lë shkollimin dhe punën dhe të përqendrohëm në obligimet e mia si grua dhe të qëndroj pranë tij. Unë pasi mendova dhe u konsultova me familjen time e refuzova këtë gjë. E ardhmja ime është në punën dhe studimet e mia.

Të merret me studime është më mirë:

Fatime Tajjib, e diplomuar dhe amvise, thotë: Unë i kam tri vajza që janë në një shkallë të lartë të besimit dhe bukurisë. Dy nga ato kanë përfunduar studimet dhe ne jetojmë në një nga lagjet e pasura të Kajros. Atyre nuk u është ofruar një djalë i përshtatshëm kështu që e kam parë të udhës që ta zënë kohën e tyre me studime. Vajza ime e madhe pasi që përfundoi magjistraturën filloi punën në një universitet privat, ndërsa e dyta është duke përgatitur magjistraturën dhe sipas mendimit tim kjo është më mirë se sa të presin deri në një afat të panjohur.

Silva AbdulKader, studente në Fakultetin e Pedagogjisë, e sheh se është më mirë që vajza të martohet gjatë studimeve ngase, ajo mendon se studimet nuk e pengojnë gruan e martuar. Përkundrazi, martesë mund të jetë

faktor suksesi dhe stabiliteti për të. Po ashtu, gjurmët e martesës janë pozitive ngase, ajo i ofron gruas shtytje për të arritur kulmin e suksesit. Disa studente nuk kanë mundësi t'i vazhdojnë studimet vetëm se pas martesës ngase, rrethanat martesore të aftësojnë për sukses dhe për lumturi të vërtetë.

Ndërsa, Fajze Atif e prezanton përvojën e saj personale ku thotë: Përvoja ime është shumë e suksesshme dhe e mirë me begatinë e Allahut. Unë jam martuar derisa kam qenë në shkollë të mesme e megjithatë kam arritur sukses dhe jam regjistruar në Fakultetin Filologjik. Tashmë jam në vitin e tretë dhe kam dy fëmijë dhe falënderoj Allahun ngase, ia arrij t'i bashkoj familjen dhe studimet e mija. Burri im më ndihmon dhe nuk më ka penguar që kur ka kuptuar vendosmërinë time.

Shkollimi është garancë sigurie:

Dr. Hanan Salim, profesore dhe sociologjisë, vëren se shtesa e mesme është më tepër e interesuar për studimin e fëmijëve të tyre ashtu që ambiciet për studimin e fëmijëve të tyre janë më të mëdha sesa martesë. Kjo ndodh kështu ngase, studimet janë garancë sigurie për ta, ku synimi i vajzës drejt martesës zë vendin e tretë d.m.th. pas studimeve dhe punës.

Dr. Hanan, gjithashtu, pohon se statistikat në Egjipt tregojnë praninë e gjashtë milionë të rinjve dhe të rejave që i kanë kaluar të 35-at ndërsa janë të pamartuar.

Unë i kam tri vajza që janë në një shkallë të lartë të besimit dhe bukurisë. Dy nga ato kanë përfunduar studimet dhe ne jetojmë në një nga lagjet e pasura të Kajros. Atyre nuk u është ofruar një djalë i përshtatshëm kështu që e kam parë të udhës që ta zënë kohën e tyre me studime.

Kjo është një dukuri që e quajmë 'Abstenim nga martesë' dhe në mesin e këtij gjashtëmilionëshi, dy milionë prej tyre gjenden në poste të larta dhe kanë një shkallë të lartë të bukurisë. Megjithatë, ata i gjejnë duke anashkaluar martesën ngase, sipas këndvështrimit të tyre, kanë interesime të shumta, më të rëndësishme.

Dr. Ferexh Ilham, profesoreshë e sociologjisë, thotë se natyrshmëria e femrës është shpresa për një jetë martesore. Vajza që e vogël ëndërron të bëhet nuse dhe luan me kukullën sikur të jetë fëmijë i vogël. Të tilla janë edhe shumica e nënave, të cilat, sado që të arrijnë vajzat e tyre grada shkencore, ëndërrojnë ditën kur vajzat e tyre do ta veshin fustanin e nusërisë. Por, realiteti dikton shumë çështje ngase, çdo nënë dhe çdo vajzë shpresojnë për një burrë sa më shembullor dhe gjithashtu e teprojnë në kërkesat e tyre materiale, e kur vajza të jetë e bukur dhe të ketë një gradë shkencore është vështirë ta gjejë djalin e përshtatshëm e ëndrrave të saj. Për këtë arsye shumica e vajzave që veçohen me kulturë dhe dije vonohen në martesë.

E kundërta ndodh me vajzat që kanë shkollim mesatar, e të cilat që nga fillimi kanë përcaktuar qëllimin e tyre në jetë, e ai është arritja e një burri dhe lehtësimi për këtë. Qoftë edhe nëse kjo dikton martesën e një vajze me shkollim mesatar, prej një familjeje mesatare, me dikë që është më pak i arsimuar, ose, për tu shprehur më mirë, që nuk është fare i arsimuar.

E nëse çdo rregull ka përjashtim ajo çka po ndodh tash i ka ndryshuar peshojat e shoqërisë, ku gjen p.sh. vajzën e cila e marton shefin e saj në punë, apo vajzën e cila martohet me dikë që është me

dekada më i vjetër se ajo, vetëm për shkak të pasurisë së tij.

Ndërsa Dr. Ali Ridvan, profesor i psikologjisë, thotë: Ajo që po ndodh tani nuk është çështje që vajza ka mundësi të zgjedh ngase ofertat për martesë për shumë vajza janë të pakta ashtu që, është rritur niveli i beqarisë për këtë, këto vajza drejtohen drejt përfundimit të studimeve të tyre. Dhe është vërejtur se niveli i beqarllëkut mes profesoreshave në universitete, mjekeve dhe inxhinierëve është më i madh se sa atyre që kanë përfunduar fakultete tjera.

Martesa dhe Mëmësia është më mirë

Dr. Ahmed Mexhdub, specialist i qendrës kombëtare për çështje shoqërore dhe kriminale, preferon martesën e vajzës që studion nëse i ofrohet një rast i volitshëm dhe e arsyeton këtë se Islami që ka rregulluar jetën e njerëzve, burrit ia ka dhënë mbikëqyrjen e familjes dhe duke u bazuar në këtë atij i takojnë shpenzimet e ajo që duhet ta bëjë shoqëria është që t'i gjejë punë këtij të riu që shpenzon për familjen e tij.

Përderisa Dr. Rafet Uthman, profesor në Fakultetin e Sheriatit, pohon se hadithi i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Kur t'ju vij dikush që ia pëlqeni devotshmërinë dhe moralin e tij martojeni përndryshe, do të ndodhin mëkate dhe çrregullim në tokë", është një udhëzim pejgamberik që duhet ta kuptojmë mirë dhe sado që të arrijë gruaja grada shkencore martesë dhe mëmësia për të janë çështje esenciale. Mirëpo, nëse nuk vjen burri i përshtatshëm atëherë, shkenca, studimi dhe të mësuarit e fesë gjithashtu, shtimi i diturisë në lëmi të ndryshme qofshin ato fetare apo

lëmi tjera, janë më mirë sesa koha e lirë e cila zakonisht sjellë probleme dhe e rraskapitë vajzën dhe familjen e saj.

Dr. Ismail Safeti e shpjegon qëndrimin e disa familjeve për mos t'i martuar vajzat e tyre gjatë studimeve me frikën për të ardhmen e tyre dhe frika e tyre rrjedh nga droja se vajzat e tyre nuk do të jenë të afta të bartin shumë përgjegjësi e veçanërisht edukimin e fëmijëve.

Dhe ai nuk sheh pengesë në martesën e hershme nëse gjendet pjekuria mentale dhe trupore ngase, martesë e vonshme dhe lindja e fëmijëve vonë e shkakton një boshllëk mes prindërve dhe fëmijëve.

Opinionet rreth martesës ndryshojnë prej një vaje tek tjetra dhe lidhen ngushtë me edukimin që e ka përfituar vajza në rrethin familjar. Disa vajza e shohin martesën si ikje nga realiteti i shtëpisë, disa prej tyre nuk kanë liri të vendosin dhe të shprehin dëshirat e tyre dhe të tjera që baballarët e tyre i privojnë nga shansi për të studiuar.

Dr. Ismail Safeti pohon se përgatitja e vajzës gjatë kohës së studimeve për martesën dhe komponentët e saj është çështje e domosdoshme dhe nuk bën të anashkalohet. Gjithashtu, martesë ia shton vajzës pjekurinë dhe kulturën mirëpo, gjatë viteve të hershme dhe periudhës së studimeve është përplot me presione për shkak të moshës së re dhe përvojës së pakët jetësore.

Dr. Ismail Safeti kërkon që të ngutet me martesën e vajzës në disa raste si p.sh gjatë shthurjes së familjes ngase, i ekspozohet devijimit dhe në disa raste tjera ku vajza anon nga mëkati dhe familja i frikësohet devijimit të saj.

Përktheu: Driton LEKAJ

A duhet të legalizohet aborti?

shkruan: Muhamed DËRMAKU

Abort është dalja e embrionit nga mitra e femrës para se ai të mund të jetojë vetvetiu d.m.th. para se të arrijë 6 muaj që nga data e ngjizjes ose para se ta arrijë peshën 0.5 kg. Ose ndryshe disa e quajnë abortin si mbyetje e foshnjës para se të lindë.

Aborti mund të jetë spontan dhe artificial.

- Aborti spontan është të dalurit e embrionit nga mitra e nënës në mënyrë të natyrshme pa ndikim të jashtëm të çfarëdo forme të ndikimit.

Si p.sh. i ashtuquajturi aborti i har-
ruar. Ky ndodh që foshnja të mos
zhvillohet fare pasi të ketë
ndodhur ngjizja dhe të
zhduket me gjakderdhje.
Pastaj aborti si shkak i frikës,
apo lodhjes etj.

- Aborti artificial mund të
jetë terapeutik dhe kriminal.

Aborti terapeutik është aborti
artificial që bëhet për motive shën-
detësore qoftë të nënës apo të
fëmijës. Kurse aborti kriminal
është aborti artificial, që nuk është
spontan apo artificial terapeutik.
Pra, abort kriminal është çdo
lloj aborti që bëhet me
ndikim të jashtëm
për motive të tjera,
që s'kanë të bëjnë
me shëndetin e
nënës apo të foshn-
jës.

Lloji i abortit, i
cilin hyn në debat
dhe ndahen mendime
lidhur me faktin nëse
duhet apo jo të legalizohet
është aborti artificial krimi-
nal. Sa i përket abortit spon-
tan, askush nuk bën fjalë
për të, pasi që ai ndodh nga
jo vullneti i njeriut dhe si i
tillë nuk mund të hyjë në
debatin e të lejuarës dhe
të ndaluarës, humanes
dhe johumanes etj.
Andaj edhe unë në
këtë punim do të
zgjerohem më
tepër në këtë
lloj aborti,
kurse për



abortin terapeutik do të ndaj një paragraf dhe të shohim se me çfarë kushtesh mund të lejohet.

Motivet e përgjithshme të abortit artificial

- motive medicinale si shkak i rrezikimit të jetës së nënës
- motive të gjendjes shëndetësore të frytit si përcjellje e ndonjë sëmundjeje trashëguese ose tjetër.
- motive shoqërore për të mbuluar turpin e marrëdhënieve seksuale ilegale
- motive sociale, duke u frikësuar se shtimi i një anëtari të ri në familje shkakton pamundësi për përkujdesje financiare
- motivi i planifikimit familjar, duke përcaktuar numrin e dëshiruar të anëtarëve të familjes etj.

Për të arritur deri te ndonjë përfundim i arsyeshëm, kësaj teme, ashtu sikundërse edhe shumë të tjerave, duhet qasur nga aspekti fetar islam, nga aspekti shëndetësor si dhe nga ai social.

Pse duhet të shikohet qëndrimi islam në lidhje me abortin?

Feja Islame si fe e vërtetë dhe e shpallur prej Allahut, Krijuesit të gjithësisë, përveç anës së besimit dhe adhurimit, përmban në vetvete edhe anën ligjore, me anë të së cilës Ligjvënësi i Madhëruar ka rregulluar anën juridike të jetës së njeriut besimtar. E sidomos në ato çështje, për të cilat mendja e shkurtër dhe e kufizuar e njeriut është e paaftë të vendosë rregull të qëndrueshëm, të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Kështu që, sistemin ligjor islam e gjejmë modelin e parë legjislativ, prej të cilit u shërbyen ligjvënësit në tokë.

Se sa korrekte dhe aktuale janë mësimet kur'anore, këtë e tregojnë dëshmitë e shumta dhe të shpeshta të shumë e shumë shkencëtarëve që me mund e sakrificë të vetëmohueshme, angazhohen tërë jetën e tyre për të zbuluar diç nga shkenca bashkëkohore, dhe në fund e gjejnë se ai studim i tyre është përmendur qysh para 14 shekujve në fjalën hyjnore të Allahut, në Kur'an.

Se sa korrekte dhe aktuale janë mësimet kur'anore, këtë e tregojnë dëshmitë e shumta dhe të shpeshta të shumë e shumë shkencëtarëve që me mund e sakrificë të vetëmohueshme, angazhohen tërë jetën e tyre për të zbuluar diç nga shkenca bashkëkohore, dhe në fund e gjejnë se ai studim i tyre është përmendur qysh para 14 shekujve në fjalën hyjnore të Allahut, në Kur'an. Siç është rasti i shkencëtarit të madh në lëmin e anatomisë dhe embriologjisë, Keith L. Moore, profesor në Universitetin e Torontos në Kanada, i cili pas një studimi të gjatë në etapat e krijimit të njeriut në mitër, erdhi në përfundim se kjo gjë në mënyrë të detalizuar ishte përmendur në Kur'an para 1400 viteve. Gjë kjo, që e shpui ta pra një Islamin dhe shkroi një libër, ku bëri krahasim mes mësimëve islame (Kur'anit dhe Sunnetit) dhe shkencës bashkëkohore me titull: "The Developing Human, clinically oriented embryology", i cili u përkthye në më shumë se tetë gjuhë të botës.

Rasti tjetër është i shkencëtarit tjetër amerikan, Marshall Xhanson, përgjegjës i katedrës së anatomisë të Universitetit "Tomas Xheferson" në Filadelfia të SHBA-ve. Shkencëtari

Xheferson u befasua se si Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të!, kishte mundur që në Mesjetë të bënte një zbulim të tillë, pra etapat e zhvillimit të embrionit. Pas meditimit erdhi në përfundim se Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, nuk ka pasur kushte të dijë në atë kohë për këtë gjë dhe u bind se kjo është fjalë e Zotit, Krijuesit të embrionit, dhe përqafoi Islamin. Për më gjerësisht shiko librin "Mrekullitë shkencore në Kur'an" të autorit Abdulmexhid Zendani.

Nuk është çudi për këso lloj rastesh, sepse Allahu i Madhërishëm ka treguar në Kur'an dhe ka thënë: "E atyre që u është dhënë dije, atë që të është shpallur nga Zoti yt e kuptojnë se vetëm ajo është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëfuqishmit dhe të Lavdëruarit." (es-Sebee, 6)

Të debatosh rreth një çështjeje nëse duhet të lejohet apo jo, patjetër duhet të studiohen rrethanat e asaj çështjeje si dhe duhet të ketë ndonjë bazë mbi të cilën mund të mbështetemi eventualisht, për të qenë sa më korrekt dhe sa më të drejtë, që përfundimi mos të rezultojë me humbjen e të drejtës së dikujt me arsyetim të respektimit të dëshirës së dikujt tjetër. Në situata të këtilla, logjika e njeriut, krahas trajtimit të saj si e pastër dhe e shëndoshë, nuk është në gjendje të arrijë deri te një vendim i drejtë, që për kohëra të gjata dhe interesa gjithëpërfshirëse të ketë vitalitetin e drejtësisë dhe të mbrojtjes së të drejtave të krijesave, madje edhe të njeriut. Andaj duhet patjetër të shkohet në atë, që e thotë buri-

Me përgjegjësi mund ta themi se trajtimi i gjërave qysh në fillim, nëse do të ndodhte nga vetë njeriu, vështirë se mund të ishte real dhe i qëndrueshëm, kur dihet se ai mund të jetë i prirë nga epshi, egoja, tekat etj.

mi hyjnor e që në këtë rast do t'i ishim qasur në mënyrë direkte në udhëzimet islame, duke e pasur parasysh origjinalitetin e kësaj feje. Atë që e ka zgjedhur Krijuesi Absolut, është e drejtë dhe u përgjigjet nevojave të të gjitha kohërave. Allahu në Kur'an thotë: "Ty Muhamed të dërguam mëshirë për të gjitha botët." (el Enbijaë, 107)

Kjo çështje do të duhej të ishte tabu, kur dihen fakte të shumta historike, që rezultojnë në vërtetësinë e Kur'anit. Njeriu nuk do të dinte as të fliste dhe as të dallonte të mirën nga e

keqja, po të mos ishin mësimet qiellore nga Krijuesi i njeriut. Me përgjegjësi mund ta themi se trajtimi i gjërave qysh në fillim, nëse do të ndodhte nga vetë njeriu, vështirë se mund të ishte real dhe i qëndrueshëm, kur dihet se ai mund të jetë i prirë nga epshi, egoja, tekat etj. Përderisa popujt e hershëm

kanë jetuar atëherë kur i kanë pasuar të dërguarit e Allahut respektivisht mësimet e Allahut dhe kanë humbur e janë shkatërruar, atëherë kur i kanë kundërshtuar ata dhe mësimet qiellore, është tejet me interes për mbarë njerëzimin, e të mos flasim për vetë myslimanët, që të jenë shumë vigjilent në përcjelljen e mësimëve islame përkitazi me çështjet që mund të bëhen dukuri e keqe në shoqëri dhe të goditemi pastaj me dënimin apo dënimet e Allahut dhe të bëhemi të barabartë me popujt e zhdukur.

"A mund të zhdukemi edhe ne, kur në mesin tonë ka njerëz të mirë? - e pyeti të Dërguarin bashkëshortja e tij, Zejneb

bint el Xhahsh.

Po, kur përhapet e keqja - u përgjigj Muhammedi alejhis-selam." (Shënojnë, Buhariu, Muslimi dhe të tjerë)

Andaj në temën që po zbërthejmë duhet patjetër të konsultohet mendimi dhe qëndrimi i Islamit ndaj abortit nëse dëshirojmë të vijmë deri te një përfundim i shëndoshë dhe i dobishëm për gjithë njerëzimin.

Qëndrimi i Islamit ndaj abortit

Aborti sipas Sheriatit islam është i ndaluar në të gjitha fazat e embrionit duke filluar me ngjizjen e spermës së mashkullit në vezoren e femrës e deri në lindje. Allahu thotë: "Dhe mos i mbytni qeniet të cilat i ka ndaluar Allahu, përveç me arsye të drejtë". Mirëpo kjo ndalesë fuqizohet edhe më tepër, kur embrioni i kalon 40 ditë, që me këtë rast bëhet formësimi i foshnjës. Ndërsa ndalohet rreptësisht, atëherë kur ai i kalon 120 ditë, kur i vjen shpirti dhe vërehet i gjallë në mitër. Në këtë rast abortimi i tij në Islam konsiderohet krim ndaj njerëzimit.

Embrioni në Islam i gëzon të drejtat e foshnjës së lindur.

- Së pari nëse fryti i ka kaluar 120 ditë, pra i ka ardhur shpirti, ai do të ringjallet në Ahiret, pa marrë parasysh se do të lindet i gjallë apo i vdekur. Do të nxirret me abort apo do të lindet normal. I mbyturi apo i abortuari, do t'i kërkojë llogari kriminelëve, që nuk i dhanë mundësinë të jetojë, pra e mbytën.

- Nëse vdes trashëgim-lënësi p.sh. babai, nuk shpërndalet trashëgimia deri sa të lind edhe ai që është në mitër si trashëgimtar i mundshëm nga pasuria e lënë.

- Nuk lejohet që nëna shtatzënë të martohet në rast të shkurorëzimit apo vdekjes së bashkëshortit, gjegjësisht babait, deri sa të lindë atë që e ka barrë.

- Nëse shtatzënia vjen si rezultat i imoralitetit, nuk lejohet në Sheriatin Islam të ekzekutohet dënimi i kurvërisë mbi femrën me barrë, deri sa të lindë foshnja, pastaj të përfundojë edhe gjidhënia. E gjithë kjo vetëm e vetëm për ta shpëtuar jetën e foshnjës.

- Femrës shtatzënë, në Islam i lejohet të mos agjërojë në ramazan, ndonëse agjërimi i ramazanit është obligim i fortë për myslimanët, nëse rrezikohet shëndeti i foshnjës në embrion.

Në të gjitha këto raste, nuk lejohet që të abortohet fëmija për hir të obligimeve ndaj Allahut, andaj vallë si të lejohet aborti për hire të "dëshirave" të krijsave!?

Abortuesi, mjeku apo kushdo qoftë, i foshnjës, që ka kaluar 120 ditë, dënohet me të njëjtin dënim sikur të kishte kryer krim ndaj foshnjës së lindur. Shumë dijetarë islamë këtë dënim e shohin edhe për atë që aborton foshnjën që ka kaluar vetëm 40 ditë.

Të ndalemi pak te fjala e Allahut, subhanehu ve teala, ku thotë: "Vetëm i Allahut është pushteti i qiejve e i tokës. Ai krijon çka të dojë. Ai i falë vetëm femra atij që do, e i falë vetëm meshkuj atij që do. Ose u falë çift, meshkuj e

Sa e sa njerëz shpenzojnë kohë e mjete të mëdha materiale për të arritur shtatzëni. Por kjo nuk varet nga vetë njeriu. Andaj si i jep guxim njeriu vetes që të luaj me atë që Allahu i Madhërishëm e ka vendosur në mitër? A nuk frikësohet njeriu se mund të sprovohet pastaj me përbuzje nga Allahu?

femra, por atë që do e lë pa fëmijë (steril). Ai është i Dijshëm, i Fuqishëm." (esh-Shura, 49 dhe 50.

Nga kjo duhet të jemi të sigurt se fillimi i formimit të embrionit nuk varet nga ne. Sa e sa njerëz shpenzojnë kohë e mjete të mëdha materiale për të arritur shtatzëni. Por kjo nuk varet nga vetë njeriu. Andaj si i jep guxim njeriu vetes që të luaj me atë që Allahu i Madhërisëm e ka vendosur në mitër? A nuk frikësohet njeriu se mund të sprovohet pastaj me përbuzje nga Allahu?

Aborti në aspektin sociologjik

Të lejohet apo jo aborti është një temë sa interesante po aq edhe joreale. Kjo do të thotë të legalizohet apo jo krimi në embrion ose më mirë të themi, krimi mbi fëmijët e së nesërme së afërt gjegjësisht krimi mbi një pjesë të së ardhmes së një populli.

T'i thuhet po abortit vetvetiu shtrohet pyetja tjetër, fëmija i lindur me të meta fizike etj., për të cilin duhet shpenzuar shumë nga pasuria, vetëm e vetëm që ta shpëtojme nga vdekja e shpeshherë me aspak optimizëm për shërimin e tij dhe mbi të gjitha i padëshirueshëm për familjen në atë gjendje. Shtrohet pyetja, pse në këtë rast të mos shkohet me "zgjidhjen" e lirë në kosto, dalje nga telashet e jetës dhe të mbytet fëmija i tillë?! A nuk është vendosje e lirë në këtë rast, që prindërit të rehatohen nga ky fëmijë dhe ta largojnë nga jeta?

Besoj se është e qartë dhe

- Nëse shtatzënia vjen si rezultat i imoralitetit, nuk lejohet në Sheriatin Islam të ekzekutohet dënimi i kurvërisë mbi femrën me barrë, deri sa të lindë foshnja, pastaj të përfundojë edhe gjidhënia. E gjithë kjo vetëm e vetëm për ta shpëtuar jetën e foshnjës.

mjaft e kapshme që dallimi i këtij fëmije dhe embrionit të shëndoshë, i cili pas pak muajve mund të jetë një dritë e mirë, që mund ta gëzonte të drejtën e tij për të jetuar. Nëse për embrionin mund të themi se ai ende nuk është i gjallë dhe nuk di, atëherë edhe foshnja është e tillë.

Pejgamberi paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Të thuhet ashti i njeriut të vdekur është sikur t'ia thyesh atë kur ai është gjallë" Kjo është me të vdekurin, i cili nuk mund të kthehet më në këtë jetë, në Dynja. E çfarë është qëndrimi njerëzor me atë, i cili do të lindet dhe do të vijë në jetë?!

Arsyeja e lirisë demokratike se njeriu mund të veprojë dhe të shprehet i lirë, nuk guxon t'i shkelë normat e arsyes dhe ta legjitimojë krimin në fëmijë.

Aborti sot mbytet më shumë se 102 000 (njëqind e dymijë) foshnje në Kanada brenda një viti. Kurse në SHBA i mbytet 1.5 milion foshnje në vit.

Nëse shtrohet pyetja a më mirë është të bëhet abortimi i foshnjave të paplanifikuara apo të lindin e pastaj të braktisen nëpër kontinierë e të mbeten pa përkujdesje familjare e të përfundojnë si të vdekur apo si fëmijë të paidentifikuar?

Ne themi se të dy këto opsione janë të papranuara, dhe si të tilla, njëra nuk mund

A mund të zhduke-
mi edhe ne, kur në
mesin tonë ka
njerëz të mirë? - e
pyeti të Dërguarin
bashkëshortja e tij,
Zejneb bint el
Xhahsh.

Po, kur përhapet e
keqja - u përgjigj
Muhammedi
alejhis-selam."

Nëse embrioni i ka kaluar 120 ditë, ndalohet rreptësisht abortimi i foshnjës, përveç rastit kur vihet në pikëpyetje jeta e nënës. Nëse nëna ka mundësi të mbetet e gjallë nuk lejohet abortimi, e nëse është e sigurt që me vazhdimin e shtatzënisë nëna do të vdesë, lejohet që të ndodh abortimi, për të shpëtuar njërën jetë.

ta justifikojë tjetrën. Pra, braktisja e foshnjës së posalindur nuk e arsyeton mbytjen e saj në barkun e nënës. Por institucionet shtetërore mund të marrin masat e duhura në parandalimin e këtyre krimeve duke sanksionuar dhe duke ndaluar me ligj marrëdhëniet seksuale jologjore. Në këtë mënyrë do të parandalohej aborti kriminal, braktisja e foshnjave të gjalla si dhe kurvëria, një krim tjetër, edhe pse nuk rezultojnë pasoja të menjëhershme. Pra do të parandalohehin sëmundje të shumta që vijnë nga kjo vijë tepër negative për shoqërinë, që përfundon me virusin HIV pozitiv. Pra, liria e abortit çon deri te legalizimi i prostitucionit dhe kurvërisë, ndërsa këto të fundit sjellin fatkeqësitë shëndetësore që janë rrezik pastaj edhe për

pjesën e pastër dhe të moralshme të shoqërisë.

Aborti zbeh marrëdhëniet bashkëshortore dhe e humb seriozitetin e jetës, pasi që martesë është rrugë e krijimit të familjes e jo të zhdukjes së anëtarit të ri. Çfarë privilegji do të kishte fëmija i parë, i dytë... kundër të pestit që nuk dëshiron ta lejosh të vijë në jetë. E nëse aborti duhet të bëhet si rezultat i shtatzënisë nga kontakti jo legjitim, ky abort trumbeton kundër "dashurisë" që njëri-tjetrit i shkaktuan dhembje shpirtërore dhe fizike në këtë botë, e çfarë pret për daljen nesër para Allahut?

Aborti ka bërë të mundur që në disa shtete të Azisë së Largët të hahet gjegjësisht dhe të shitet mishi i njeriut.

Me keqardhje sot i shohim se si njerëzit tregtojnë me çështjen e abortimit si një tregti e përparuar, e mbuluar me gjoja arsyetime legjitime nën motot e "lirisë së vendosjes", "të drejtat e femrës" etj. në disfavor të së drejtës së embrionit-foshnjës për jetë. Duhet të kemi kujdes nga thirrjet e ndryshme qëllimkëqija në nivel kombëtar e botëror për "planifikim familjar", "e drejta e lindjes", "lindjet e shën-



dosha" etj. Sepse të gjitha këto thirrje mbajnë në brendinë e tyre abortin e legjitimuar.

Përjashtimet për abortin artificial terapeutik

Foshnjës i vjen shpirti pasi ka kaluar 120 ditë në barkun e nënës, siç e përmendëm më lart.

Qeveria e Arabisë Saudite, duke u mbështetur në vendimin e Komisionit të Përhershëm për Hulumtime dhe Vendime të Sheriatit, të cilin e përbën një numër i konsiderueshëm i dijetarëve më eminentë islamë, vendosi si vijon:

1. Nëse embrioni i ka kaluar 40 ditë duke mos i arritur 120 ditë, nuk lejohet abortimi, përveç në dy raste:

a) nëse të vazhduarit e shtatzënisë i shkakton nënës sëmundje të papërbalueshme, ose do të mbetet me dhembje edhe pas lindjes;

b) nëse vërtetohet se foshnja do të lindë me të meta fizike apo psikike, duke mos pasur shpresë në shërimin e saj pas lindjes.

2. Nëse embrioni i ka kaluar 120 ditë, ndalohet rreptësisht abortimi i foshnjës, përveç rastit kur vihet në pikëpyetje jeta e nënës. Nëse nëna ka mundësi të mbetet e gjallë nuk lejohet abortimi, e

Pejgamberi paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Të thyhet ashti i njeriut të vdekur është sikur t'ia thyesh atë kur ai është gjallë" Kjo është me të vdekurin, i cili nuk mund të kthehet më në këtë jetë, në Dynja. E çfarë është qëndrimi njerëzor me atë, i cili do të lindet dhe do të vijë në jetë?!

Aborti sot mbyllet më shumë se 102 000 (njëqind e dy mijë) foshnje në Kanada brenda një viti. Kurse në SHBA i mbyllet 1.5 milion foshnje në vit.

nëse është e sigurt që me vazhdimin e shtatzënisë nëna do të vdesë, lejohet që të ndodh abortimi, për të shpëtuar njëren jetë.

3. Ndalohet rreptësisht që mjeku të kryejë abort, nëse nuk ekziston ndonjëra prej këtyre arsyeve. Aborti për foshnjën që ka kaluar 40 ditë në embrion nuk guxon të kryhet, përveç në ndonjë spital shtetëror, pasi për këtë të jetë marrë vendim nga komisioni mjekësor i përbërë nga tre mjekë, së paku njëri prej tyre të jetë specialist i gjinekologjisë dhe obstetrikës, duke miratuar vendimin për abort dy prej mjekëve myslimanë, që dihet se janë të devotshëm.

Çfarëdo motivi tjetër për abort Sheriati islam e refuzon. Nëse bëhet në mënyrë legale, personi abortues përgjigjet edhe para organeve të drejtësisë islame aty ku funksionon. E nëse kjo nuk ndodh, ose aborti bëhet në mënyrë interne, kjo nuk do të mbetet kot, por Allahu do t'i llogarisë ata në gjyqin e madh të Ditës së Gjykimit, atëherë kur nuk do të humbet as detaji më i vogël. Allahu thotë: "Dhe kur të pyeten ato vajzat e mbytura për çfarë mëkati ato janë mbytur." (et tekvir, 8 dhe 9)

Legalizimi i abortit pra, hap dyert për epidemi të tjera morale, familjare, shoqërore, ekonomike, shëndetësore etj. andaj edhe është i papranueshëm dhe duhet t'i mbyllet rrugët e jo të legalizohet.


Si ta fitojmë dashurinë e bashkëshortes (2)

Elvedin PEZIQ

Në numrin e kaluar përmendëm tri mënyra se si burri mund ta përfitojë dashurinë e bashkëshortes e cila është elementi themelor për të funksionuar një lidhje martesore. U përmendën thirrja e gruas me emrin më të bukur, shakaja dhe shfrytëzimi i metodës dhuratë befasie.

Në këtë numër do të vazhdojmë numërimin e metodave që shpijnë drejt arritjes së qëllimit, martesë e lumtur dhe e suksesshme.

Meshkujt duhet ta dinë se ka dallim mes xhelozisë së burrit dhe xhelozisë së gruas. Xhelozia e gruas është shumë më e madhe dhe më e vështirë për tu kontrolluar. Nëse kësaj ia shtojmë edhe dobësinë e gruas si krijesë, atëherë problemi merr dimensione të reja. Gratë tona shpesh i paraqesin si probleme gjërat që në esencë janë të lejuara. Jo rralëherë ndodh të humbet kon-



trolli dhe të ndodh diç që aspak nuk pritet prej tyre. Por një burrë i mençur duhet t'i kapë dhe njohë këto momente, e t'i tolerojë gabimet e bëra nën atë ndikim. Nuk duhet harruar se gruaja e cila në atë mënyrë shkakton grindje apo edhe ndonjë incident, atë e bën për shkak dashurisë së madhe që ka ndaj burrit të saj.

Shembull më të mirë e kemi të Dërguarin e Allahut Muhamedin, salallahu alejhi ve selem, kur njëherë me disa as'habë ishte te Aisha radijallahu anha, gruaja tjetër nëpërmjet shërbëtores i dërgoi ushqim. Aisha radijallahu anha, kur e pa këtë e mori enën dhe e përplasi në tokë me ç'rast u derdh ushqimi. I Dërguari, salallahu alejhi ve selem, pedagogu më i mirë, mësuesi, e mblodhi ushqimin sa pat mundësi! Pastaj u tha as'habëve: "nëna juaj xhelozoi, hani nga ushqimi". [hadithin e shënon Tirmidhiu 3567, duke iu referuar Enesit radijallahu anhu dhe saktësinë e tij e vërteton Albani].

Do t'i bëjmë pyetje vetes: si do të reagonim ne sikur të na ndodhte gruaja të na e përplaste pjatën me ushqim para mysafirëve? Vet reagimi jonë do të tregojë se sa me të vërtetë ne e pasojmë të Dërguarin salallahu alejhi ve selem, në relacionet bashkëshortore.

Gatishmëria për pranimin e fajit

Feja jonë e ndritshme na urdhëron që të jemi të drejtë, madje edhe ndaj

Meshkujt duhet ta dinë se ka dallim mes xhelozisë së burrit dhe xhelozisë së gruas. Xhelozia e gruas është shumë më e madhe dhe më e vështirë për tu kontrolluar. Nëse kësaj ia shtojmë edhe dobësinë e gruas si krijesë, atëherë problemi merr dimensione të reja.

atyre që kanë bindje të ndryshme fetare dhe ideologjike nga ne. Nga kjo drejtësi assesi nuk mund të jenë të përjashtuara bashkëshortet tona. Përkundrazi ato para të tjerëve e meritojnë një trajtim të tillë. Allahu i Lartësuar thotë: "O ju që besuat!

Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën dhe mos t'ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Keni drojë nga Allahu meqë Allahu e di hollësisht atë që e veproni". (El- Maide 8)

Myslimani, atëherë kur në familje shpërthen ndonjë mosmarrëveshje apo konflikt të shkaktuar nga

ai, duhet të jetë i gatshëm ta shikojë të vërtetën në sy dhe të pranojë fajin e vet e të mundohet të mënjanojë gjithçka që shkakton këtë mosmarrëveshje. Duhet të jetë i gatshëm të kërkojë falje prej gruas së vet, ashtu siç do të kishte kërkuar prej secilit njeri të cilit i ka shkaktuar padrejtësi. Nuk është lehtë të mposhtet shejtani, "ta ulësh veten" dhe të kërkoshe falje prej gruas, mbi të cilën ndihesh më superior. Por, derisa ka pas guxim ta ofendojë bashkëshorten, e cila i shërben dhe kujdeset për të, atëherë detyrimisht duhet të tregohet guximtar edhe më i madh kur është në pyetje kërkimi i faljes. Assesi, nuk duhet të mendohet se kërkimi i faljes prej gruas është dobësi, përkundrazi ai duhet të besojë se me një sjellje të tillë respekton parimet e kësaj feje të ndrit-

shme dhe arrin kënaqësinë e Atij i Cili, kur është i kënaqur me robin e Vet bën që edhe të tjerët të jenë të kënaqur me të. Ky gjest do ta rrisë dhe në asnjë mënyrë, siç mendojnë shumica, nuk do ta ulë personalitetin e tij te gruaja. Përkundrazi, kjo sjellje do të jetë mësim për gruan, që nesër kur ajo të gabojë të jetë e gatshme të veprojë në të njëjtën mënyrë, sepse ka shembullin e gjallë në burrin e saj.

Ku qëndron problemi?

Shumica e burrave mendojnë se gjithmonë kanë të drejtë - vetëm që nuk thonë se janë edhe të pagabueshëm - ndërsa gruaja është gjithmonë gabimtare.

A është kjo drejtësia të cilën na e mëson feja jonë?!

Allahu, subhanehu ve tealu, thotë: "O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmuar të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu e di hollësisht se çfarë punoni". (En Nisa 135)

Pranimi dhe pajtimi me mangësitë dhe dobësitë e gruas

Njeriu duke jetuar me bashkëshort-

derisa ka pas guxim ta ofendojë bashkëshorten, e cila i shërben dhe kujdeset për të, atëherë detyrimisht duhet të tregohet guximtar edhe më i madh kur është në pyetje kërkimi i faljes. Assesi, nuk duhet të mendohet se kërkimi i faljes prej gruas është dobësi

en dhe duke kaluar nëpër probleme të ndryshme në martesë, arrin ta njoh mirë atë. Është e pakalueshme që në këtë rrugë të mos zbulojë ndonjë mangësi apo dobësi të saj. Por, megjithatë, nuk duhet harruar se krahas disa mangësive ajo posedon shumë më tepër cilësi të mira. Ky vlerësim do t'i ndihmojë të kalojë nëpër mangësitë e saj dhe të silltet sikur nuk i posedon fare. Sa më real të jetë, aq më e suksesshme do të jetë martesja e tij.

Shejtani vazhdimisht mundohet të ndikojë tek njeriu dhe ta bind në çdo moment të kapet për gjëra të vogla dhe pa vlerë, e të harrojë çdo cilësi e sjellje të mirë të saj. Por, ne pyesim, sa është i drejtë një vlerësim i tillë i një burri ndaj gruas së vet?

Allahu, subhanehu ve tealu, thotë: "Çoni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim, pse ndodh që Allahu të jep shumë të mira në një send që ju e urreni." (en Nisa 19)

Nëse njeriu dëshiron të bindet në vërtetësinë e kësaj metode, le të marrë një laps e një letër dhe le t'i shkruajë të gjitha cilësitë e mira dhe të këqija të gruas së vet: në të shumtën e rasteve kolona e të mirës

Çuditërisht prej bashkëshortes kërkojmë përsosmëri - ndërkohë që vet nuk jemi të tillë! Mburremi me shembujt e gjeneratave të para, ndërsa vet jemi shumë larg atyre shembujve.

do të jetë shumë - shumë më e gjatë nga ajo e të keqes. Në fund, atë listë mund t'ia jep gruas së vet që ajo të sheh se çfarë i pengon burrit të saj që në të ardhmen ato vese negative t'i përmirësojë dhe t'i zëvendësojë me sjellje pozitive, gjithmonë duke pasur për qëllim përmirësimin e atmosferës së jetës bashkëshortore dhe fitimin e dashurisë së burrit.

Burri duhet të jetë i gatshëm që edhe ai të pranojë një listë me vlerësim të atillë dhe në të shumtën e rasteve befasisht rezultati për të është: kolona e sjelljeve të këqija është më e gjatë, prandaj këtë kolonë ai duhet vazhdimisht ta ketë në mendje kur i ndodh diçka e pahijshme nga gruaja e tij.

Çuditërisht prej bashkëshortes kërkojmë përsosmëri - ndërkohë që vet nuk jemi të tillë! Mburremi me shembujt e gjeneratave të para, ndërsa vet jemi shumë larg atyre shembujve.

Ndihmesa rreth punëve të shtëpisë

Kjo është një nga pyetjet e shpesh-ta të cilën burrat e kuptojnë gabimisht. Ndihmesën gruas rreth punëve të shtëpisë, burrat e shohin si dobësi dhe gjest i ulët (për burra të tillë në shoqërinë e meshkujve thuhet se janë burracak).

Pikërisht kjo është rezultat i të kuptuarit të gabueshëm të fesë - dhe ky kuptim u takon atyre që manifestojnë fenë vetëm nga pamja e

jashtme. Po t'i kthehemi biografisë së të Dërguarit, salallahu alejhi ve selem, do të shohim se ai edhe në këtë segment ishte shembulli më i mirë, sikur që ishte në të gjitha segmentet e jetës, modeli më i përsosur në dynja. Edhe pse ai kishte obligime shumë më të mëdha se ne, të pakra-

"Çoni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim, pse ndodh që Allahu të jep shumë të mira në një send që ju e urreni."

hasueshme me obligimet tona, gjente kohë për t'u ndihmuar bashkëshorteve të veta në punët e shtëpisë.

Transmetohet se Aisha, radijallahu anha, ka thënë: "I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selleme, i ka shërbyer familjes së vet, e kur hynte koha e namazit dilte nga shtëpia e shkonte të fal namazin". [hadithin e shënon Buhariu]

Gjithashtu, kur e pyetën Aishën radijallahu anha, për të Dërguarin salallahu alejhi ve selleme, ajo tregonte: "Ishte njeri modest, milte delet dhe vet shërbehej" [hadithin e shënon Ahmedi, saktësinë e tij e ka vërtetuar Albani Es- Sahiha 621]

Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar se burri duhet pandërprerë të punojë punët e shtëpisë, sepse është e vërtetë se ato janë obligim i gruas, por nëse ndonjëherë ndihmon e sidomos në raste kur ka nevojë, ky gjest është e sigurt se do të ndikojë në rritjen e dashurisë së gruas ndaj tij.

Përktheu: Remzije KURTISHI

Problemi i dezinformatave në shkolla mbi Islamin

Një prej brengave të mëdha të prindërve myslimanë është arsimit publik dhe ndikimi i tij potencial mbi rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Duke u munduar që në psiken e fëmijëve të tyre t'i rrënjosin thellë identitetin islam dhe vlerat e forta morale, ata në të njejtën kohë detyrohen që fëmijëve t'ua potencojnë rëndësinë e arsimit dhe vlerave që instalohen nga ai. Prindërve myslimanë u është më se e nevojshme të kenë qasje proaktive në arsimimin e fëmijëve të tyre. Me fjalë tjera, prindërit duhet të kenë kyqje.

Mirëpo, vetëm kyqja nuk është e mjaftueshme. Qasjen që dikush e ka, është shumë me rëndësi, ngase ai kështu - në një periudhë afatgjatë - përcakton se çka do të arrini Ju si prindër, si dhe cilat probleme do të jeni në gjendje t'i zgjidhni në fushën e arsimit. Është rregull se personi duhet të ketë qasje pozitive dhe vazhdimisht të mban kontakte me të tjerët në mënyrë që ju të dëshmoni se mund të ofroni diçka që do të jetë e dobishme. Do të ishte e dëmshme nëse merrni qëndrim, në të cilin vazhdimisht do të ankoheshit ose do ishit të shqetësuar. Sidoqoftë, shumica e problemeve dhe brengave më shumë janë rezultat i paditurisë sesa qëllimeve të këqija, ndonëse edhe kjo, në disa raste është e



mundur. Megjithatë, në të ardhmen, duhet të përmirësohet prezantimi i myslimanëve dhe Islamit në librat shkollorë. Për momentin në botë qarkullon një numër i madh i librave, të cilat përdoren edhe në SHBA-të dhe në vendet tjera të botës dhe të cilat përmbajnë informata të pavërteta dhe joadekuate rreth Islamit dhe historisë së myslimanëve.

Për ta zgjidhur këtë problem, myslimanët duhet të marrin përsipër përgjegjësinë, që shkollave të tyre në afërsi, t'ju sigurojnë informacione të vërteta. Në Kaliforni si dhe në shume shtete të tjera, Islami mësohet në klasën e shtatë (fillore). (në Bosnje dhe Hercegovinë, ajo është në kuadër të mësim-besimit, e cila është lëndë sipas dëshirës, në histori dhe letërsi-sh.p.) Kjo ndoshta ndryshon në disa rajone. Si prind, kur është në pyetje shkollimi i fëmijëve tuaj, Ju keni më shumë të drejtë se ndonjë arsimtar, apo drejtor i shkollës, në të cilën mësojnë fëmijët tuaj.

Për momentin në botë qarkullon një numër i madh i librave, të cilat përdoren edhe në SHBA-të dhe në vendet tjera të botës dhe të cilat përmbajnë informata të pavërteta dhe joadekuata rreth Islamit dhe historisë së myslimanëve.

Duke marrë parasysh këtë gjë, ekzistojnë disa gjëra që ju si prind i brengosur, mund dhe duhet t'i bëni, kur fëmija i juaj dhe fëmijët tjerë në klasë mësojnë informata të pavërteta mbi Islamin.

Lexoni librat shkollore të fëmijëve tuaj dhe vlerësojeni shkallën e dezinformimit

Së pari, duhet të njoftohesh me librat e fëmijës suaj, veçanërisht ato të lëmvive të shkencave shoqërore dhe historisë. Nëse ndjeni se keni aftësi për atë, Ju vet mund të përmirësoni pjesën në të cilën flitet për Islamin, ose mund të kërkonin nga dikush që është kompetent, ta bën këtë për Ju. Në çdo rast, përmirësimi duhet të bëhet me shkrim. Çdo pjesë e dezinformimit duhet shënuar dhe çka është me rëndësi, duhet të ofrohet versioni i përmirësuar i çdo pjese.

Realizoni takim me mësuesin e lëndës

Kur ta përfundoni përmirësimin, shtypeni në formë të rregulluar dhe në mënyrë të qartë. Duhet të kërkonin takim me mësuesin e fëmijës Suaj, si dhe me personin që është përgjegjës për plan-programin e asaj lëmi. Mësuesi do të jetë në gjendje, që në orët e tij në atë mënyrë të përmirësuar të kombinon ndryshimin të cilin e keni propozuar, kurse personit përgjegjës për plan-programin në atë lëmi, do t'i bëhet

e qartë se ekziston dikush që nuk lejon një gabim të tillë të kalon pa u hetuar.

Gjatë takimit reagoni në mënyrë pozitive me qëllim të zgjidhjes së problemit

Me rëndësi është të dihet se, kur të takoheni me mësuesin dhe drejtorin, duhet të keni një qëndrim të qetë, miqësor por edhe me dozë të dukshme brengosëse. Akuzimi i mësuesit për dezinformata do të ishte gabim i madh. Mësuesit janë të stërngarkuar dhe të angazhuar vetëm në mësimdhënie. Ata janë të fundit që pyeten dhe assesi nuk janë vendim-marrësit për përmbajtjen e teksteve. Reagimi më i mirë do të ishte që ju të merrni qëndrim, me të cilin do ta shprehni pakënaqësinë tuaj rreth shpjegimit të Islamit në librin e dhënë, dhe se do të ishit në gjendje të ndihmonit në mënjanimin e dezinformimit.

Varësisht nga qëndrimi që do të merrni do të krijohet atmosferë e takimit. Në këtë mënyrë mësuesve dhe drejtorit, mund t'i ofroni përmirësimin Tuaj, si dhe materiale shtesë, për të cilat mendoni se do t'i ndihmojnë mësuesit, që të mbajë mësimin me përmirësimet rreth Islamit.

Solidarizimi me shkollën dhe mësuesit

Si shtesë mund të propozoni që një ditë klasa apo e tërë shkolla, të thërret një ligjërues i cili do të bën prezantimin e Islamit. Gjithashtu, udhëzoni mësuesin drejt burimeve tjera të informacionit, siç janë qendrat islamike ose organizatat.

Mund t'i jepni shkollës/ mësuesit dhuratë një Kur'an me përkthim ose Hyrje në historinë islame.

Marrë nga: www.dawanet.com

përktheu: Fatmir Dashi

Rroga e merituar



Pyetje:

Hoxhë i nderuar, kam bërë kontratë për punë (gojarisht) me rrogë 250 euro, mirëpo në fund të muajit zotëriu pagesën e rrogës ma ka bërë me denarë, 15.000 denarë. Këto para, siç e dini, nuk janë fiks 250 euro, por janë më pak. i kam dërguar një njeri që ta këshillojnë, por ai ka vazhduar si më parë. Edhe pse dallimi nuk është aq i madh, megjithatë kur llogariten për një vit (p.sh.) më dëmton për afër 80 euro. Ai më ka autorizuar në arkë. Pyetja ime është a i lejohet atij ta bën këtë dhe si e shqyrton këtë sheriatu islam. Pyetja e dytë është se a më lejohet (me autorizimin që kam) të marr atë dallimin që ai ma ndalë në pagesën e rrogës me valutë tjetër?

Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje:

Në emër të Allahut me emrin e të cilit nuk bëhet dëm në toke dhe as në qiell, Ai dëgjon gjithçka dhe sheh gjithçka.

Kontrata është nga rregullat e shitblerjes

dhe po edhe në marrëdhëniet tjera ndërnjerzore. Sheriatu islam e ka evidentuar këtë gjë kështuqë ne e hasim në librat e dijetarët të fikhut të cilët kanë dhënë sqarime për kontratën dhe rregullat e saja në detaje. Allahu i madhëruar ka thënë:

"O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë. Dhe nga gjiri juaj le të shkruajë një shkruar i drejtë dhe të mos ngurrojë nga të shkruarit ashtu siç e ka mësuar Allahu. Le të shkruajë, e atij le t'i diktojë ai që pranon borxhin, le t'i frikësohet Allahut, Zotit të tij e të mos lërë mangut asnjë send nga ai ..."

Ky ajet aludon në shkrimin e kontratës mes dy palëve, pra qoftë ajo për borxh, apo kontratë tjetër dhe ajo të bëhet me dëshmitar.

Hakim ibn Hizami rrëfen se Pejgamberi - paqja dhe bekimi qoftë mbi të, ka thënë: Shitësi dhe blerësi kanë të drejtë të zgjedhin derisa nuk janë ndarë. Nëse e thonë të vërtetën (janë besnik) dhe qartësojnë marrëveshja e tyre do të bekohet, e nëse fshehin dhe gënjejnë, u fshihet bereqeti në atë marrëveshje. Muttefekun alejhi

Këto tekste aludojnë në marrëveshje mes dy palëve mes të cilëve duhet të ketë korrektësi dhe qartësim të plotë të punës që duhet ta bëjë punëtori dhe përcaktim të rrogës që duhet ta jep punëdhënësi. Prej këtyre teksteve po edhe të tjerave nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik, në këtë temë dijetarët e umetit kanë nxjerrë rregulla dhe përkufizime. Prej tyre është edhe përkufizimi: kontrata mes dy palëve për punë është kontratë për shfrytëzimin mubah (e lejuar) të artikullit (objektiv apo subjektiv) për gjë të caktuar, për gjë të cilësuar me garanci, me kohë të caktuar, me kompensim të caktuar.

Në këtë përkufizim janë përmbledhur kushtet më të rëndësishme të marrëveshjes për punë:

Disa sqarime të rëndësishme të përkufizimit:

Mubah (e lejuar): Së pari, marrëveshja për punë duhet të jetë e lidhur me gjëra të lejuara, prandaj çdo marrëveshje për punë me haram, nuk lejohet të bëhet.

Njëra nga palët bën punën, ndërsa pala tjetër bën pagesën sipas marrëveshjes.

Për gjë të caktuar: Ashtu siç caktohet puna duhet të caktohet paga.

Për gjë të cilësuar: Nëse nuk është në vend të punës, atëherë duhet të përmenden përshkrimet e mjaftueshme pa lënë mangut asgjë.

Me kohë të caktuar: Në këtë kontratë, po ashtu, duhet të definohet orari i punës. Çdo punë jashtë orarit duhet të paguhet veçmas.

Me kompensim të caktuar: Rroga, apo paga qoftë ajo ditore (mëditja), javore, apo mujore duhet të jetë e caktuar dhe duhet të veprohet ashtu siç përmendet në kontratë.

Gjeneza e marrëdhënieve ndërnjerëzore (muamelat) përqendrohet në kon-

ceptin e drejtësisë, gjegjësisht asnjëris palë mos t'i bëhet padrejtësi.

Allahu i madhëruar është i drejtë, e do drejtësinë dhe i do ata që punojnë me drejtësi.

Allahu i madhëruar ka thënë: "...mbani drejtësinë, se vërtet Allahu i do të drejtit. " Huxhurat 9

Padrejtësinë nuk e do dhe i urren ata që bëjnë padrejtësi. Allahu i madhëruar ka thënë: "...Ai (Allahu) nuk i do zullumqarët. Shura 40

Ai që bën padrejtësi në dynja dhe nuk e përmirëson derisa është gjallë, apo nuk ia bën hallall atij i dëmtuari, atëherë ai atë dëm do ta paguan me sevapet e tija, apo do të ngarkohet me gjynahet e atij që i ka bërë padrejtësi.

Ebu Hurejre rrëfen se Pejgamberi - paqja dhe bekimi qoftë mbi të, ka thënë: A e dini kush është i falimentuar? Të pranishmit thanë: i falimentuar në mes nesh o i dërguar i Allahut është ai që nuk ka dërhëm dhe asgjë. Ai (Pejgamberi paqja dhe bekimi qoftë mbi të), u tha: i falimentuar në umetin tim është ai që vjen në Ditën e Kiametit me agjërime, me namaz, me zekat, mirëpo ka sharë nderin e këtij, e ka nëpërkëmbë atë, ia ka ngrënë pasurinë atij. Kur e marrin ta gjykojnë, ia marrin të mirat dhe ia japin atij të cilit i ka bërë padrejtësi, e kur t'i harxhohen të mirat para se ta gjykojnë për gabimet e tij, ia marrin mëkatet e atij që i ka bërë zullum dhe ia japin këtij e pastaj e shtyjnë në Zjarr.

Shënon Imam Ahmedi transmeton në Musnedin e tij

Këto tekste duhet të jenë të mjaftueshme për besimtarin që druan nga Allahu dhe brengoset për llogarinë e Ditës së Gjykimit, ndërsa për palën më të dobët duhet të paraqesin stimulim për të

bërë sabër.

Sa i përket pyetjes së dytë: A lejohet që të marrë diferencën prej arkës në të cilën ka autorizim nga zotëriu?

Kjo nuk lejohet. Në arkë je i autorizuar me amanet dhe për shkak se zotëriu gëzon besnikërinë tënde. Allahu i madhëruar kur i ka cilësuar besimtarët, ka thënë: "dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë " Mu'minun 8. Nëse ai zotëriu ka dështuar në këtë aspekt, nuk e ka mbajtur premtimin e dhënë dhe bën padrejtësi, ai do të përgjigjet vet për veprat e veta, por kjo nuk duhet të ndikojë te punëtori që t'ia kthejë padrejtësinë me të njëjtën mënyrë (me padrejtësi). Ai duhet ta ruajë besnikërinë dhe korrektësinë, të bëjë durim, të ketë frikë Allahun dhe të pret prej Allahut t'i krijojë rrugëdalje. Allahu i madhëruar ka thënë: "e kush i frikësohet (u përmbahet dispozitave të) Allahut, atij Ai ia hap rrugën dhe e furnizon atë prej atje ku nuk e kujton fare, ..." Talak 2 - 3

Edhe ata që udhëheqin sipërmarrje, duhet të kenë frikë nga Allahu në hakun e punëtorit. Nëse nuk e bëjnë pagesën korrekte sipas asaj që e kanë potencuar në marrëveshje, ata e njollosin pasurinë e tyre me haram. Duhet të jenë të vetëdijshëm se me atë pasuri ushqehen vet ata, ndërsa, po ashtu, mbajnë dhe ushqejnë familjen e tyre. A thua vallë pajtohen me këtë, apo janë nën anestezi të dynjasë. Nëse njeriu ushqehet me haram, vishet me haram, ai arrin në një gjendje shumë kritike në raport me Allahun.

Ebu Hurejrës rrëfen se Pejgamberi - paqja dhe bekimi qoftë mbi të, ka thënë: O ju njerëz, Allahu është i mirë (I pastër) dhe nuk pranon asgjë tjetër përpos të mirën (të pastrën). Allahu i ka urdhëruar

besimtarët me atë që i ka urdhëruar të dërguarit duke thënë: "O ju të dërguar, hani nga gjërat e mira (hallall) dhe bëni vepra të mira se Unë e di hollësisht atë që veproni", dhe ka thënë: "O ju të cilët keni besuar, hani nga gjërat e mira (hallall) me të cilat ju kemi furnizuar", pastaj e përmendi një njeri që kishte marrë rrugë të gjatë, i rraskapitur dhe i pluhurosur nga rruga, ka ngritur duart nga qielli duke thënë: O Zot, o Zot, mirëpo ushqimin e ka me haram, rrobat i ka me haram dhe është ushqyer me haram, ndaj si t'i pranohet lutja këtij?! Transmeton Muslimi

Prandaj, çdo besimtar që ka punëtorë, le t'i frikësohet Allahut në çështjen e punëtorëve dhe le të ketë kujdes me ta se mund të privohet prej shumë gjërave për shkak të shkeljes së ndalesave të Allahut.

Shtojcë: Disa punëtorë ankohen nga pronarët e tyre se pos pagesave të vogla që i kanë, ata i detyrojnë të punojnë edhe punë shtesë dhe ua shtojnë ditët e punës. Ata thonë se 15 minuta para se t'u mbarojë orari i punës, sjellin kamionin me mall dhe u thonë punëtorëve ta shkarkojnë, kështu që ata mbesin deri në orë të vona të natës duke shkarkuar kamionin. Pos kësaj, ata i detyrojnë punëtorët që edhe çdo të diel të dytë ta punojnë. Punëtorët kanë frikë të ankohen se mos po i përjashtojnë nga puna.

Edhe kështu nuk bën të veprohet meqë, duke u mbështetur në tekstet e lartpërmendura, kjo paraqet shkelje të hakut të punëtorëve dhe nëpërkëmbje të tyre.

Në numrin e ardhshëm - insha'allah, do të keni rastin të lexoni më gjerësisht lidhur me atë se si e shqyrton sheriatin këtë çështje.

U përgjigj: Ali SHABANI

Përshkrimi i momenteve të Ahiretit 2/2

shkruan: Agim BEKIRI

Tetë: Peshorja

Peshorja është një e vërtetë e pakontestuar dhe obligohemi ta besojmë. Atë do ta vendosë Allahu, subhanehu ve teala, për t'i matur veprat e robërve dhe më pas për t'i shpërblyer ata. Peshorja është konkrete, ka dy krahë dhe një gjuhë. Me të maten veprat ose fletoret ku janë regjistruar veprat apo vetë vepruesi. Të gjithë këto mund të maten mirëpo shkak i rëndimit apo lehtësisë do të jetë vepra, jo vepruesi e as fletoret me qeniet e tyre.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshore të drejta, e askujt nuk i bëhet asgjë e padrejtë, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrre të melit Ne do ta sjellim atë. Ndërsa mjafton që Ne jemi llogaritës". (Enbija: 47)

Po ashtu, thotë: "Atë ditë peshimi (masa) është i drejtë. Atij që i rëndohen peshojat, ata janë të shpëtuar. Kujt i vijnë lehtë peshojat, ata e humbën vetveten, ngase i refuzuan argumentet Tona me të padrejtë". (A'raf: 8,9)

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "pastërtia është gjysma e imanit kurse fjala "elhamdulillah" e mbush peshoren përplot". (Muslimi)



Nëntë: Sirati

Obligohemi të besojmë në Siratin që është një urë e vendosur mbi Xhehenem, vendkalim i frikshëm dhe trishtues. Njerëzit për të hyrë në Xhennet duhet të kalojnë nëpër të. Dikush prej tyre do të kalojë shpejtë si një kapsallitje e syve, dikush sikur vetëtima, tjetri si era, tjetri si shpendi fluturues, dikush sikur kalorësi me at të mirë, tjetri si një vrapues i shkathët. Dikush do të kalojë duke ecur, tjetri do ta kalojë zvarrës. Ata do të kalojnë në një mënyrë që varet nga veprat e tyre, nga besimi i tyre i cili do të bëjë dritë. Sa më të fortë që ka pasur besimin aq më tepër dritë do të ketë dhe si i tillë do të kalojë më

shpejtë. Ndonjëri do të rrëmbehet dhe do të hidhet në zjarr. Ai që arrin ta kalojë Siratin do të hyjë në Xhennet.

I pari që do ta kalojë është Muhammedi, salallahu alejhi ve selem, pastaj ummeti i tij. Atë ditë nuk do të flet kush pos pejgamberëve. Lutja e tyre do të jetë: o Allah, shpëto, shpëto!

Në Xhehennem, nga dy anët e Siratit ka kthetra që vetëm Allahu e di se si duken. Me to do të rrëmbehen ata që duhet të dënohen në zjarr.

Sirati është më i mprehtë se tehu i shpatës, më i hollë se qimja, është rrëshqitës, këmbët nuk mund të qëndrojnë po qe se nuk i përqendron Allahu, subhanehu ve teal. Ai është në errësirë. Emaneti dhe lidhja farefisnore do të qëndrojnë në dy anët e tij për të dëshmuar për ata që kanë pasur ato dy cilësi.

Allahu, subhanehu ve teal, thotë: "Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t'i afrohet atij. Ky (kontaktim i xhehennemit) është vendim i kryer i Zotit tënd. Pastaj, (pas kalimit pranë tij) do t'i shpëtojmë ata që ishin ruajtur (prej mëkateve), e zulumqarët do t'i lëmë aty të gjunjëzuar". (Merjem: 71,72)

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "do të ngritët një urë mbi Xhehennem, unë dhe ummeti im do të jemi të parit që do ta kalojmë". (Muslimi)

Në një hadith tjetër thotë: "do të ngritët një urë mbi Xhehennem kurse unë do të jem i pari që do ta kaloj. Lutja e pejgamberëve atë ditë do të jetë: o Allah, shpëto, shpëto!" (Muttefekun alejhi)

Ebu Seid el-Hudri thotë: kemi dëgjuar se ura mbi Xhehennem është më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata" (Muslimi)

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "do të dërgohen amaneti dhe lidhja

farefisnore në dy anët e Siratit, nga e djath-ta dhe nga e majta. I pari prej jush do të kalojë si vetëtima... pastaj sikur era, pastaj si shpendi, pastaj si vrapues i shkathët, varësisht prej veprave të tyre. Pejgamberi juaj do të qëndrojë në fund të siratit duke u lutur: o Zot, shpëto, shpëto, deri sa veprat nuk do të jenë të mjaftueshme për dikë. Do të vijë ndonjëri i cili s'do të mund të ecë vetëm se duke u zvarritur. Ai tha: në dy anët e Siratit ka kthetra që kanë për obligim t'i rrëmbejnë ata për të cilët janë urdhëruar". (Muslimi)

Dhjetë: Kantare

Besojmë se besimtarët pasi të kalojnë Siratin do të ndalen në vendin e quajtur Kantare. Ai është një vend mes Xhennetit dhe Xhehennemit. Besimtarët do të ndalen në atë vend për të marrë hallallëk me njëri-tjetrin para se të hyjnë në Xhenet. Pasi që të pastrohen atëherë marrin lejen për të hyrë në Xhenet.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "besimtarët do të shpëtojnë prej Zjarrit dhe do të ndalen në Kantare. Do të marrin hallallëk prej njëri-tjetrit për disa padrejtësi që i kanë bërë në dynja, derisa të pastrohen, atëherë marrin lejen për të hyrë në Xhenet. Pasha atë në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, çdonjëri do të dijë të gjejë shtëpinë e tij në Xhenet më mirë së që ka ditur të gjejë shtëpinë e tij në dynja." (Buhariu)

Njëmbëdhjetë: Xheneti dhe Zjarri

Besojmë se Xheneti është i vërtetë dhe Zjarri (Xhehemi) është i vërtetë. Ato ekzistojnë dhe do të mbeten përgjithmonë. Begatitë e Xhennetit nuk kanë fund ashtu siç nuk ka fund dënimi i Allahut për ata që do të jenë përgjithmonë në Zjarr.

Sa i takon besimtarëve, ata do të dalin me ndërmjetësim (shifat) dhe mëshirën e Allahut. Xheneti është shtëpia e nderimit të cilën Allahu, subhanehu ve teala, e ka përgatitur për të devotshmit. Aty ka lumenj që rrjedhin, dhoma ta ngritura lartë dhe gra të bukura. Aty ka gjithçka që shpirtit ia ka ënda dhe që kënaq syrin. Gjëra që syri nuk i ka parë, veshi s'i ka dëgjuar e as që ndokujt i ka shkuar ndërmend. Vendi i Xhenetit sa mund të zë një rrip është më i mirë se dynjaja dhe çka ka në të. Era e tij ndihet katërdhjetë vite larg. Begatia më e madhe në të është shikimi i Fytyrës së Allahut me sytë e ballit.

Mosbesimtarët nuk do të shohin Allahun, andaj ai që mohon faktin se besimtarët do të shohin Allahun, ai u ka ngjasuar mosbesimtarëve.

Në Xhenet ka njëqind gradë. Distanca mes njëres dhe gradës tjetër është sikur mes tokës dhe qiellit. Xheneti më i lartë është Firdeusi kulmi i të cilit është Arshi i Allahut.

Xheneti ka tetë dyer. Krahët e një dere janë larg prej njëri-tjetrit sikur mes Mekës dhe Hexherit. Një ditë do të jetë përplot me njerëz që do të vrapojnë për të hyrë.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "i përgatitur për të devotshmit" (Ali Imran: 133)

"Shpërblimi për ta te Zoti i tyre janë: vendet në xhenete nëpër të cilët burojnë lumenj, e aty janë përgjithmonë, pandërprerë. Allahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata janë të kënaqur prej Tij. E kjo është për atë, që i ka pasur drojë Zotit të vet." (Bejjine:8)

Xhehenemi është vendi i dënimit që Allahu e ka përgatitur për mosbesimtarët dhe mëkatarët. Aty është dënimi më i ashpër dhe i llojlojshëm. Rojtarët e tij janë melekët e ashpër. Mosbesimtarët do të qëndrojnë aty përgjithmonë. Ushqimi i tyre do të jetë Zekkumi dhe vala. Zjarri i

kësaj bote është një e shtatëdhjeta e zjarrit të botës tjetër. Çdoherë që dikush hidhet në të do të thotë: a ka edhe të tjerë. Ai ka shtatë dyer, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "është përgatitur për jobesimtarët" (Ali Imran - 131)

"Allahu i ka mallkuar jobesimtarët dhe për ta ka përgatitur zjarr të ndezur fort. Aty do të mbesin përgjithmonë dhe nuk do të gjejnë kë t'i mbrojnë apo t'i ndihmojë." (Ahzab: 64,65)

Frytet e besimit në Ditën e Ahiretit:

1. Nxitja për të bërë vepra të mira, kujdesi për to me qëllim që të arrihet shpërblimi.

2. Frika nga mëkatet për të mos u dënuar.

3. Inkurajimi i besimtarit se gjërat që nuk i ka arritur në këtë dynja e presin në Xhenet.

4. Besimi në ringjalljen është çelësi i lumturisë së individit dhe shoqërisë. Njeriu nëse beson se Allahu, subhanehu ve teala, do t'i ringjallë krijesat e tij, do t'i merr në pyetje dhe do t'i shpërblejë për veprat e tyre, ai do ta ndjekë rrugën e drejtë dhe do të largohet nga të këqijat. Në këtë mënyrë e mira do të mbizotërojnë në shoqëri, do të instalohen vlerat e larta dhe mirëqenia.

Sirati është më i mprehtë se tehu i shpatës, më i hollë se qimja, është rrëshqitës, këmbët nuk mund të qëndrojnë po qe se nuk i përqendron Allahu, subhanehu ve teala. Ai është në errësirë. Emaneti dhe lidhja farefisnore do të qëndrojnë në dy anët e tij për të dëshmuar për ata që kanë pasur ato dy cilësi.

Letër maturantit

I lutem Allahut që prej këtyre fjalëve të kem dobi unë dhe ju.

Isha zhytur në detin e kthjelltë të mendimeve dhe papritmas mu kujtuan fjalët e gjyshit tim të vdekur, që më thoshte: "Nipi im, mbaje mend se kur njeriu lind mban gishtin në gojë, ndërsa kur ritet mban gishtin në kokë".

Shkak i kësaj gjendje që mu krijua në shpirt, nuk ishte vetmia, as brengosja për ndonjë gabim që kam bërë, por as vdekja që na ndau me gjyshin tim të mençur, por fakti se unë tani gishtin tregues duhet ta drejtoj kah mëndja, sepse arrita moshën e Maturantit.

Mosha rinore është shumë e bukur dhe shumë e mirë, në qoftë se shfrytëzohet në punë të mira, mirëpo ajo mund të bëhet e errët dhe shumë e keqe për dikë, nëse shfrytëzohet në rrugë të këqija.

Allahu rininë e çmon, andaj nëpërmjet lajmëtarit të tij, Muhamedit paqja dhe bekimi qoftë mbi të, e porosit njerëzinë që ta shfrytëzojnë kohën në rini para se tu vjen pleqëria.

Prej kur je regjistruar në shkollë të mesme, maturën e ke ëndërruar, ditët po kalojnë, e ti për natën e maturës po planifikon...

A nuk e di se, gjerrat që të bëjnë dëm shejtani t'i zbukuron, e ti thjesht po mashtrohesh dhe Allahu e hidhëron, pse ia mundëson që maturën të ta uroj shejtani.

Vëlla dhe motër!

Allahu është i hidhëruar dhe nuk është i kënaqur në vendet ku dëgjohe muzika, vendet ku është e përhapët lakuriqësia, vendet ku përzihen meshkuj e femra, vendet ku konsumohet alkooli etj.

Motër, A nuk po të vjen turp prej Allahut, që përgatitesh për një nate kalimtare dhe planifikon të veshësh një fustan, me çka do ta reklamosh trupin tënd para meshkujve të huaj.

A deri këtu ka ardhur morali i motrave tona myslimane, që të kërcejnë dhe përdridhen sikur i dehuri, t'i shkundin pjesët e trupit si femra të amoralshme dhe...

Vëlla dhe motër e respektuar!

Ti sigurisht ndjehesh e vetmuar dhe mendon se do ngelësh i vetëm, dhe e ndjen veten të braktisur, e ndoshta i pa përkrahur nëse nuk shkon në natën e maturës.

Ndoshta të kap panik dhe shumë shpesh ndjehesh i pafuqishëm ndaj kësaj sprove që të ka goditur.

Ndoshta të vjen në mendje se, po gabon nëse nuk shkon në Maturë.

Mirëpo mos harro se Allahu është me besimtarët!!

Andaj vëlla dhe motër e ndershme!

A nuk është turp që t'i japim rëndësi dhe të harxhojmë kohe që të përgatitemi për një nate të thjeshtë që zgjate ca ore dhe ta hidhërojmë Allahun!

A nuk është padrejtësi që të kalojmë kohën bosh dhe të mos mendojmë për ahiret.

A nuk po shikojmë se shejtani na mashtron me këtë bote kalimtare e cila nuk peshon të Allahu edhe sa fleta e mushkonjës.

- O ti që mashtrohesh, o ti që je neglizhent ndaj urdhrave të Allahut, o ti që shpreson jetë të gjate, a të ka shkuar ndërmend të përgatitesh për një ditë kur vdekja do të kaplojë, e petku yt i maturës do të jetë dheu.

Oj rini e dashur!

Pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqerte.

Ndije shijen e pendimit, përjeto ëmbëlsinë e lotëve, shtrydhe zemrën dhe ndije dhembjen që rrjedh loti mbi faqe, që me të ti shuash zjarret e mëkateve që i ke bere.

Vetmohu, pranoi gabimet, lute Zotin dhe thuaj: O Allah unë jam gabimtar dhe kam bere shume padrejtësi, andaj pendohem dhe te lutem me fal.

O Allah të lutem me lutjen e nevojtarëve, kam shprese te Ti, shpresë të frikësuarve, shpresë të atyre që u janë shtuar mëkatet dhe kanë pakë sevape, që i kanë kapluar mëkatet dhe nuk kanë gjetur të mëshirshëm tjetër pos Teje, e nuk kanë gjetur ndihmës tjetër pos Teje, o Allahu im.

Armond Rape